

RRUGA TEK PARATË

MONITORIMI I
PROKURIMIT PUBLIK
NË MINISTRINË E
INFRASTRUKTURËS

MARS 2016



RRUGA TEK PARATË

PRISHTINË,
MARS 2016

**MONITORIMI I
PROKURIMIT PUBLIK
NË MINISTRINË E
INFRASTRUKTURËS**

COPYRIGHT © 2016. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
HYRJE	9
METODOLOGJIA.....	10
TRANSPARENCA NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS	11
VLERËSIMI I KONTRATAVE PËR MIRËMBAJTJEN VERORE DHE DIMËRORE TË RRUGËVE NACIONALE DHE REGJIONE....	13
1. REGJIONI: PRISHTINA 1	19
2. REGJIONI: PRISHTINA 2.....	22
3. REGJIONI: PRIZRENI 1	25
4. REGJIONI: PRIZRENI 2.....	27
5. REGJIONI: FERIZAJ 1	29
6. REGJIONI: FERIZAJ 2.....	31
7. REGJIONI: GJAKOVA 1	33
8. REGJIONI: GJAKOVA 2	35
9. REGJIONI: PEJA 1	37
10. REGJIONI: PEJA 2.....	39
11. REGJIONI: MITROVICA 1	40
12. REGJIONI: MITROVICA 2	42
13. REGJIONI: GJILANI 1	44
14. REGJIONI: GJILANI 2.....	46
ANKESAT E OPERATORËVE EKONOMIKË DHE EFIKASITETI I TRAJTIMIT TË TYRE.....	48
REKOMANDIME	50

HYRJJE

Që nga viti 2011, fusha e prokurimit publik në Kosovë ka zgjuar interesim të jashtëzakonshëm tek Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/Transparency International Kosova (TIK). Kjo për faktin se ky sektor për çdo vit konsumon një pjesë të madhe të buxhetit publik, dhe tash e sa kohë, dhe për arsye se ende përcillet me mangësi të shumta sa i përket vendosje së rregullit dhe kontrollit në këtë sektor. Më 2013 KDI ka publikuar një raport që fokus ka pasur edhe Ministrinë e Infrastrukturës. Ky publikim i vitit 2013 ofron një bazë të mirë krahasuese të gjendjes në këtë institucion, edhe pse metodologjia e përdorur ndryshon.

KDI-ja në këtë hulumtim analizon tenderin i cili në kohën e publikimi të këtij raporti është në realizim e sipër në

Ministrinë e Infrastrukturës. Subjekt të këtij raporti janë analizimi i gjithsej katërbëdhjetë (14) kontratave të dhëna me një procedurë tenderuese, që për qëllim kanë mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe rajonale në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Nga analiza e kësaj procedurë tenderuese janë verifikuar dhe nxjerrë rezultate, konkluzione dhe sugjerime, bazuar në gjetje dhe parregullsi të evidentuara gjatë të gjitha fazave të saj. Megjithatë, ky raport nuk lë pa përmendur edhe gjetjet pozitive, kurdo që ka pasur të tilla.

KDI falënderon Ambasadën Britanike në Prishtinë që ka bërë të mundur hulumtimin dhe këtë raport.

METODOLOGJIA

Metodologjia e hulumtimit në këtë raport tenton të matë zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, përmes ekzaminimit të kontratës së Ministrisë së Infrastrukturës “Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e Rrugëve Nacionale dhe Regjionale për Vitin 2014” e cila është analizuar në faza të ndryshme.

Për shkak të natyrës së kontratës së përzgjedhur, analiza trajton pesë (5) faza të prokurimit: vlerësimin e nevojave dhe planifikimit, përgatitjen e specifikacioneve teknike, vlerësimin e ofertave, zbatimin e kontratës dhe monitorimin e performancës, dhe fazën e auditimit dhe përmbylljes. Përpos tyre, kjo metodologji trajton nivelin e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimin e Operatorëve Ekonomik (OE), si dhe ankesat e deponuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe vendimet e marra nga ky organ.

Kjo metodologji e hulumtimit dhe monitorimit në prokurimin publik është një nga praktikatat të cilat përdoren gjerësisht nga organizatat mbikëqyrëse dhe kryesisht nga degët e Transparency International, nëpër shtete të ndryshme³.

Përparësi kryesore e kësaj metodologjie është fakti se është gjithëpërfshirëse dhe nuk anashkalon asnjë nga fazat e prokurimit. Rëndësi të posaçme i është dhënë bashkëpunimit me operatorët ekonomik, përkatësisht bizneset të cilat janë në marrëdhënie kontraktuale me Ministrinë e Infrastrukturës.

Gjatë përpilimit të këtij raporti janë përdorë metoda të shumta për mbledhjen e të dhënave si ajo përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, orga-

nizimin e fokus grupeve, kërkesa për sqarime përmes e-mailave zyrtare, organizimin e grupit punues me operatorët ekonomik si dhe me ofertues në këtë procedurë tenderuese.

Dokumentet të cilat janë përdorur gjatë ekzaminimit të tenderëve kanë qenë: raportet e vlerësimit të tenderit, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimin për kontrata, dosjen e tenderit, ofertat e operatorëve ekonomik, ankesat e operatorëve, vendimet e OSHP-së, plani për menaxhimin e kontratës, faturat e pagesave mujore apo sipas realizimit të vëllimit të punimeve, etj. Monitorimi aktiv i projektit do të përmirësojë performancën e përgjithshme të institucioneve me buxhet/rrezik të lartë, si dhe përfshirja e akterëve të ndryshëm në këtë proces do të sjell përfitime për të gjitha palët e përfshira në proces. Pjesëmarrësit nga komuniteti i biznesit (të cilët nuk e kanë fituar tenderin), OJQ-të, gazetarët e mediave kërkimore, anëtarë të Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, Autoritetet Kontraktues, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm do të kenë mundësinë të përfitojnë nga njohuritë e KDI të fituara ndër vite.

³ Transparency International. (2006). *Handbook for Curbing Corruption in Public Procurement*. Berlin: Lisa Prevenslik, Kenneth Kostyo. Për më tepër: http://www.transparency.org/whatwedo/pub/handbook_for_curbing_corruption_in_public_procurement



TRANSPARENCA NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS

Transparenca është sinonim i qeverisjes së mirë, llogaridhënies dhe i ngritjes së besimit tek qytetarët në institucione publike.⁴ Transparenca e qasjes në dokumente publike është e drejtë themelore e të gjithë qytetarëve për t'u informuar se si paraja publike është duke u shpenzuar.

Kjo është hera e dytë që KDI bënë monitorimin e Ministrisë së Infrastrukturës, dhe vlen të potencohet së qasja në dokumente publike në këtë institucion është përmirësuar dukshëm vitin e fundit, andaj bazuar në këtë fakt mund të përfundohet se ka rritje të nivelit të transparencës në këtë ministri. Megjithatë, mirëmbajtja dhe organizimi i arkivës është në nivelin shqetësues. Kjo arkivë është e pa organizuar. Në disa raste madje ishte e pa mundur gjetja e disa dokumenteve nga ofertat e operatorëve ekonomik.

Për shkak volumit të madh të dokumenteve për qasje, dhe në mungesë të kapaciteteve për t'i fotokopjuar dokumentet, zyrtarët e MI kanë ofruar në dispozicion të hulumtuesit të KDI-së mundësinë që t'i bëjë fotokopje dokumentet e kërkuar në kërkesën e parë të datës 29 Korrik 2015. Megjithatë, për shkak se Zyra e Auditorit Gjeneral dhe auditorët e brendshëm, ishin duke audituar të njëjtin tender, KDI ka pasur mundësi të ketë qasje në kontratat me operatorët ekonomik fitues, vetëm pas kalimit të kohës prej 3 muaj e 10 ditë nga dita e parqitjes së kërkesës. Më datë 7 dhjetor, KDI ka kërkuar qasje në

paramasat e përmirësuara për mirëmbajtje Verore dhe Dimërorë për te gjitha Regjionet por, KDI-ja nuk e ka pranuar këtë dokument edhe pas zotimeve të zyrtares së MI-së se do t'i dërgojnë dhe se i njëjti do të dërgohet përmes e-mailit. Qasja në paramasat e përmirësuar ishte e mundur vetëm përmes ndihmës nga OE-të.

Një tjetër kërkesë për qasje në dokumente zyrtare ishte dërguar më datë 9 dhjetor 2015, dhe vetëm pas insistimit nga hulumtuesi i KDI-së, ministria kishte udhëzuar që të dërgohen dy kërkesa të ndara, për secilin departament veç e veç, edhe pse zyrtari përgjegjës ka mundur lehtë të kanalizojë kërkesën tek departamentet relevante. Faktori i jashtëm nuk mund të jetë në dijeni të plotë për organizimin e brendshëm të institucionit publik. Më datë 30 dhjetor 2015, KDI-ja ka bërë dy kërkesa⁵ për qasje në dokumente publike por edhe pas insistimit të vazhdueshëm të hulumtuesit të KDI-së, deri më datë 8 shkurt 2016, KDI-ja nuk ka pranuar kurrfarë përgjigje nga Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve të MI.⁶ Ndërsa Departamenti për Buxhet dhe Financa më datë 5 shkurt 2016, ka siguruar qasje në pagesat bërë për secilin situacion për tërë regjionet, nga nënshkrimi i kontratës dhe për vitin 2015 komplet.

5 Kërkesa për qasje në dokumente publike drejtuar Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Departamentit për Buxhet e Financa në Ministrinë e Infrastrukturës.

6 Me datën 22 Janar 2016 ju është dërguar përsëri e njëjtë kërkesë në të dy departamentet. Me datën 27 Janar 2016, drejtorët e departamenteve përkatëse z. Besnik Hajdari dhe z. Rexh Osmanaj ishin kontaktuar përmes telefonit nga hulumtuesi i KDI-së, por edhe përkundër qasjes pozitive, nuk ka rezultuar me qasjen në dokumente publike në lidhje me kërkesën e datës 30 dhjetor 2015.

4 Shih Maja Augustyn, Cosimo Monda, "Transparency and Access to Documents in the EU: Ten Years on from the Adoption of Regulation 1049/2001", qasur së fundi më datën 11 dhjetor 2015.



Kërkesa e fundit për qasje në dokumente publike është dërguar në MI, më datë 18 janar 2016. Departamenti i prokurimit, kishte lejuar qasje në dokumente brenda afatit ligjorë.

Nga të gjitha kërkesat e parashtruara në këtë ministri, departamenti i prokurimit publik ishte me efikas në kthimin e përgjegjës dhe bashkëpunimit. Ndërsa kërkesat e drejtuara në departamentet tjera si atë të financave dhe departamentin e menaxhimit të rrugëve kishte vonesa të konsiderueshme. Vonesat në departamentin e financave ishin arsyetuar në mungesë të stafit për të siguruar kopjet e dokumenteve të kërkuara dhe volumit të punës që ka të bëjë me rishikimin e buxhetit.

VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI

Sipas planifikimit dhe vlerësimit të nevojave të aktiviteteve tenderues, të parapara në LPP⁷ ekzistojnë dy hapa fillestarë që duhet plotësuar në çdo procedurë të prokurimit.

Vlenë të theksohet se pas plotësimit të paramasave dhe specifikimeve teknike, vlera përfundimtare e parashikuar për projektin, për një vit, është vlerësuar të jetë rreth: 10,282,311.42€. ⁸ Megjithatë, pas evidentimit të një gabimi teknik në sasinë e paramasave verore për regjionin Prishtina 1, numri i sasive ishte rritur, andaj edhe totali i shumës së vlerësimeve për një vit është në vlerë prej 10,384,998.82 €. ⁹

Duhet të theksohet se vërehet një mospërputhje kohore e deklaratës së nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve dhe shpalljes së tenderit. Njoftimi për kontratë në ueb-faqen e KRPP-së, është bërë më datë 22.05.2014,

⁷ Ligji Nr. 04/L-42, Nenin 8 Planifikimi i prokurimit, dhe Nenin 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përbushur.

⁸ Shkresë e datës 25.06.2014 drejtuar drejtorit të departamentit të prokurimit nga drejtori i departamentit të infrastrukturës Rrugore.

⁹ Shkresë e datës 04.07.2014 drejtuar drejtorit të departamentit të prokurimit nga kryetari i komisionit për hartimin e paramasave.

ndërsa deklarata e vlerësimit të nevojave është e datës 25.06.2014. Nenin 9 paragrafi (1) i LPP-së, kërkon që “[p]ara se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues.” Pra është shumë e qartë se çdo vlerësim i nevojave duhet të kryhet para fillimit të çfarëdo aktiviteti të prokurimit.

UDHËHEQJA E PROCEDURAVE TË TENDERIMIT DHE PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE DETYRUESE

Parregullsitë në udhëheqjen e procedurave të tenderit dhe aplikimi i specifikimeve teknike diskriminuese, vazhdon të jetë problematike për Ministrinë e Infrastrukturës.

Njoftimi për kontratë kornizëpër shërbime, në ueb-faqen e KRPP-së është bërë më datë 22.05.2014, me numër të prokurimit MI 14-051-211 ndërsa numri i prokurimit në dosjen e tenderit figuron si MI 13-051-211. Afati i fundit i caktuar për dorëzim ishte më datë 02.07.2014. Kriteri i dhënies së kontratës ishte çmimi më i ulët. Në zbatim të vendimit të OShP-së, Autoriteti Kontraktues ka zgjatë afatin për dorëzimin e ofertave deri me datën 11.09.2014. Në këtë vendim të OShP-së janë ndryshuar edhe disa specifikime teknike të cilat do të sqarohen në seksionin e ankesave të operatorëve ekonomik. Afati i dorëzimit të ofertave ishte zgjatur edhe njëherë deri më datën 15.09.2014 pasi që një nga operatorët ekonomik ishte ankuar se e kishte pranuar dosjen e tenderit vetëm një ditë para dorëzimit të tenderit. Ndërsa njoftimi për dhënie të kontratës është bërë më datën 30.10.2014, ku edhe janë kontraktuar 14 operatorë ekonomik, për gjithsej 14 regjione të Kosovës.

Seksioni i ankesave sqaron në detaje argumentet kyçe të secilës ankesë dhe vendimet të lëshuar nga OShP. Megjithatë, për qëllim të shtjellitimit të përgatitjeve të kriterëve të dosje së tenderit, rastet do të cekën sipas

nevojës. Ministria e Infrastrukturës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues ka bërë përgatitjen e kriterëve të dosjes së tenderit në formatin e paraparë me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP).¹⁰

Para së të detajojmë kriteret e dosjes së tenderit vlen të përmendet se dosja fillestare e tenderit është modifikuar tri (3) herë. Më datën 26 qershor operatorët ekonomik përmes e-mailit kanë pranuar ndryshimet në paramasa, paralogari dhe specifikimet teknike të tenderit, ndërsa kushtet tjera të dosjes së tenderit mbeten të njëjta. Në lidhje me këtë raportin e auditorit të përgjithshëm, thekson se “specifikacioni teknik ishte ndryshuar, derisa kjo nuk është vërejtur se është inicuar edhe nga njësia kërkuese.”¹¹ Gjatë monitorimit, KDI po ashtu nuk kishte vërejtur se ka ndonjë kërkesë nga njësia kërkuese. Nga kopjet e emailave të konsultuara, vërehet se tek disa operatorë ekonomik, përmirësimet ju janë dërguar më datën 30 qershor 2014.

Përmirësimi i dytë i paramasave për regjionin Prishtina 1, ju është dërguar operatorëve ekonomik më datën 09 korrik 2014. Sipas njoftimit, ndryshimi është vetëm tek sasishtë e planifikuara, ku në vend që të jetë 196,700 metra gjatësi ka mbetur 19,670 metra.

Ndryshimi i fundit në dosjen e tenderit erdhi pas vendimit të OShP-së të datës 29.08.2014 i cili kërkoi që të përmirësojë paragrafin 9.1 dhe 9.2 të FDT-së, respektivisht që kontrata të noterizohet nga të gjithë operatorët ekonomik dhe jo vetëm operatorët ekonomik fitues, si dhe të zgjatet afati për këtë aktivitet të prokurimit. Ndryshimet e fundit të dosjes së tenderit ju janë dërguar operatorëve ekonomik më datën 01 shtator 2014.

Autoriteti Kontraktues ka paraqitë kriteret e dosjes së tenderit si në vijim:

¹⁰ Ligji Nr. 04/L-42.

¹¹ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të ministrisë së infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, faqe 22.

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik:

- Kërkesat e specifikuar sipas nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 \ L-42;
- Kërkesa, se OE fitues i tenderit është në rregull në lidhje me pagesat e tatimeve;
- Kërkesa në lidhje me raportet për gjendjen financiare të shoqëruara me pasqyrat financiare të tenderuesit për tri vitet e fundit, të certifikuar nga Auditori i Licencuar.

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit-kopje;
- Certifikata e TVSh-së kopje;
- Në rast kur tenderuesi është një grup operatorësh ekonomik, një Draft Kontratë ku është përcaktuar, dhe autorizuar udhëheqësi i grupit për nënshkrimin dhe dokumenteve tjera – origjinale;
- Në rastin kur tenderuesi është një grup i operatorëve ekonomik, një deklaratë e secilit partner në lidhje me përgjegjësit sipas LPP-së – origjinale;
- Një Draft Kontratë mbi sigurimin e vendpunishtes nga një kompani e licencuar sigurimeve për:
- Mbulimin e sigurimit për personelin dhe sigurimin ndaj palëve të treta – origjinal;
- Mbulimi i sigurimit për automjete dhe pajisje sipas specifikacionit teknik në dosjen e tenderit - origjinal;
- Mbulim i sigurimit për automjete dhe pajisje sipas specifikacionit teknik në dosjen e tenderit – origjinal;
- Mbulimi i sigurimit për pasurinë e operatorit ekonomik – origjinal

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, janë parashtruar si kërkesa minimale në lidhje me kapacitetet financiare të operatorëve ekonomik. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, minimumi 20% e vlerës së ofertës (qasje në kredi), që specifikon projektin me referencën e caktuara – origjinale.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Pas ankesës së njërit nga operatorët ekonomik, kërkesat e pozicionit 9.1 të dosjes së tenderit janë të paraqitura pas përmirësimit nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me vendimin e OShP-së të datës 29.08.2014, me referencë 241/14. Andaj kërkesat teknike dhe/ose profesionale në këtë kategori të kërkesave janë të fundit si në vijim:

- Menaxher i projektit, të jetë inxhinier i diplomuar me tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit dhe të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar.
- Personeli kryesor teknik (udhëheqës i punishtes), një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktivë, me dy (2) vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës në projektet e ndërtimit, reabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve, minimumi dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar. Të jetë në listën e pagave së paku në gjashtë mujorin e fundit ose të ketë kontratë me ofertuesin për këtë projekt. Kontrata të duhet të vërtetohet të noterit. Para vendimit të OShP-së kontrata është kërkuar të jetë e noterizuar vetëm për fitues.
- Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me dy (2) vite përvojë punë pas diplomimit, ose gjeodet me shkollë të lartë, me tri (3) vite përvojë punë pas diplomimit, dhe të ketë minimum dy projekte të realizuar në lëmin e kërkuar. Kësaj kërkesë duhet t'i bashkëngjiten, kopja e diplomës ose licenca e noterizuar, dëshmitë e përvojës së punës në lëmin e kërkuar dhe kontrata e punës me ofertuesin, ose marrëveshje për bashkëpunim me punëdhënësin, duke specifikuar titullin e projektit për të cilën ka lidh kontratë-marrëveshje.

- Inxhinier i diplomuar i komunikacionit më dy vjeçare në projektet e infrastrukturës rrugore dhe strukturave.

Ndërsa kërkesat e përmirësuar nuk përfshinë kërkesën e më hershme të dosjes së tenderit në lidhje me një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi hidroteknik me përvojë punë dy vjeçare në projektet e infrastrukturës rrugore dhe strukturave). Vendimi i OShP-së nuk ka kërkuar që të tërhiqet kjo kërkesë, andaj është e pa qartë pse është tërhequr ky kriter.

Për të gjitha kërkesat e theksuar deri më tani janë kërkuar të paraqitën diplomat përkatëse të noterizuara, kontratat e punës dhe letër referencë për punët e më pashme në lëmin e kërkuar të noterizuar.

Në lidhje me këtë pikë të diskutimit, nga fokus grupi i organizuar¹² me operatorët ekonomik ndër të tjera është potencuar se mënyra e vendosjes së kriterëve janë diskriminuese sepse ju jepet përparësi operatorëve që kanë të njëjtën eksperiencë me institucione publike brenda tri (3) viteve të fundit. Po ashtu, një kriter tjetër që është konsideruar diskriminues gjatë diskutimeve me operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender, është kërkesa që diplomat universitare të inxhinierëve të jenë katër (4) vjeçare, kurse me sistemin e Bolonjës fakulteti tani është tre (3) vjeçar. Pra ka mospërputhje të kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe sistemit aktual të edukimit në Kosovë.

- Vlera e përgjithshme monetare e punëve të ekzekutuara në lëmin e ndërtimit, rikonstruktimit ose reabilitimit (asfaltimit) të rrugëve në tri vitet e fundit, për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më i vogël se dyfishi i vlerës së ofertës.

Operatorët ekonomikë të përfaqësuar në fokus grup kanë theksuar se në mënyrë të vazhdueshme aplikohet kriteri diskriminues që operatorët ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik të ofrojnë dëshmi të përgjithshme monetare të punëve të ekzekutuara në lëmin e ndërtimit,

¹² KDI, fokus grupi i mbajtur me datën 30.10.2015.

rikonstruktimit të rrugëve jo me të vogël se dyfishi i vlerës së ofertës në tri (3) vitet e fundit. Ky kriter direkt favorizon kompanitë që në tri vitet e fundit kanë pasur kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve. Operatorët e tjerë ekonomik as që kanë mundësin të sjellin një reference të tillë sepse në tri vitet e fundit nuk kanë qenë mirëmbajtës të rrugëve. I njëjti kriter diskriminues krijon monopol sepse asnjë operator tjetër ekonomik nuk ka mundësi për pjesëmarrje në procedurat tenderuese, përveç nëse për të hyrë në konsorcium i nënshtrohet kushteve dhe kërkesave të operatorit aktual (ose të fundit) që i mirëmban rrugët.

Kur bëhet fjalë për hyrjen në konsorciume, gjatë diskutimit në fokus grupin e organizuar nga KDI, nga operatorët ekonomik është theksuar fenomeni i shumë të favorizimeve politike. Nga viti 2009 kanë dalë në pah shumë kompani të reja që kanë marr kontrata të ndryshme në mungesë të eksperiencës, por që janë arsyetuar në bazë të partnerëve të konzorciumeve, dhe janë bllokuar kompanitë e vjetra.¹³ Në këtë skenar, shumicën e punëve i delegojnë partnerit në konzorcium duke e tejkaluar vlerën e lejuar të paraparë me ligj. Rreziku i kësaj është se të qenurit në treg favorizon kompaninë liderë, e cila në fakt nuk posedon kapacitete për kryerjen e punëve, dhe kështu kompania me vogël mbaron punët e liderit mbi normën e paraparë me ligj. Domosdoshmëria e të hyrit në konzorcium favorizon monopolin për kompanitë që janë me herët në treg. Efektet anësor të këtij lloji kriteri është se e dëmton konkurrencën e tregut të lirë.

- Një kontratë sa ½ e ofertës në tri (3) vitet e fundit.

Në kriter të dosjes së tenderit po ashtu kërkohet një kontratë sa ½ e ofertës në tri (3) vitet e fundit. Ky kriter dhe kriteri paraprak, janë dy kritere që krijojnë konfuzion tek operatorët ekonomik, se a duhet të jetë dëshmia jo më e vogël se e dyfishit të ofertës apo sa ½ që i bije sa gjysma e ofertës. Kjo çështje ishte ngritur edhe në ankesën e operatorit ekonomik "Victoria Invest"¹⁴, ndërsa paneli shqyrtues i OShP-së në vendimin e datës 29 korrik 2014, përveç konstatimit se nuk ka shkelje të nenin 68 të

¹³ KDI, fokus grupi i mbajtur me datën 30.10.2015.

¹⁴ OShP, Ankesa më numër 241/14, data 15.07.2014., faqe 6.

LPP-së, dhe që shablloni i referohet nenit 8 paragrafit 3 të rregullores së prokurimit publik, pa e sqaruar si është ky specifikim në përputhje me këto nene. Megjithatë, ky pretendim ankimor meriton të kritikohet sepse nuk është mjaft qartë i artikuluar nga operatori ekonomik.

Për dy kriteret e fundit është kërkuar dëshmi që në lëmin e kërkuar në periudhën e shkuar trevjeçare, të bashkëngjiten referencat apo procesverbalet e pranimit të projekteve të punëve në lëmin e kërkuar.

- Për realizimin e këtij projekti nevojiten minimumi 20 punëtorë për një llot së bashku me pasqyrat tati-more vjetore (për tri vitet e fundit) e të punësuarave në kompaninë e juaj e dhënë nga ATK.
- Bazë për prodhimin e asfaltit e licencuar, në pronësi, apo marrëveshje për furnizim.
- Gurëthyes i licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr (agregat).
- Bazë e licencuar, për prodhimin e betonit me kapacitet të mjaftueshëm për realizimin e punëve të betonit ose marrëveshje për furnizim me beton me një prodhues të licencuar të betonit.

Në lidhje me tri kriteret e fundit është kërkuar prezantimi i licencës valide të lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.

- Shoferët e kamionëve 6 tonësh duhet të jenë të pajisur më patente shofer të kategorisë "C" – nëse oferta përfshinë me shumë se një pjesë, numri i personelit duhet të rritet në varësi të numrit të pjesëve/loteve për të cilat oferton
- Një deklaratë mbi fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik dhe numrit mesatar të personelit menaxherial për secilin nga tri (3) vitet e fundit (e paraqitur në formën e detajuar.



- Mjetet, stabilimentet¹⁵ dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj siç është e caktuar më poshtë:
- Bazë për prodhim të asfaltit me kapacitete minimale prej 80 tonë/ose në pronësi ose marrëveshje për furnizim për të njëjtën vlerë
- Gurëthyes të licencuar në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një operator ekonomik i cili ka gurëthyes të licencuar (me kapacitete jo më të vogla se 30 m3 orë)
- Lista e pajisjeve të kërkuara e vërtetuar nga noteri i licencuar dhe e noterizuar
- Automjetet, depot dhe pajisjet teknike që duhet të sigurohen nga ofertuesi i shërbimeve përveç atyre që vë në dispozicion MI për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes dimërore do të jenë si më poshtë:
- Për pastrimin e borës dhe shpërndarjen e materialeve që i kundërvihen akullit duhet përdorur kamion më kapacitet bartës minimum 6 tonë, fuqi minimale e motorit 73,5 kw (100 kf).
- Kontenier më pajisje shpërndarëse që montohet mbi kamion me kapacitet deri në 5 m3 dhe aftësi shpërndarës të kripës deri 25g/m2.
- Plug për pastrimin e bores që montohet përpara kamionit, me një teh çeliku me gjerësi 2,5 deri 2,9 m.
- Deponimi i kripës duhet bërë nën një konstruksion ndërtimor të mbuluar. Depoja duhet të plotësoj kushtet e ruajtjes dhe manipulimit pa lagështi të kripës.

15 Në grupin punues mbajtur më Operatorët Ekonomik, më datën 29 Janar 2016, ndër të tjera theksohet se “kërkesa për t’i pasur të gjitha pajisjet e regjistruara po paraqet një barrë të madhe për operatorët ekonomik, meqë OE-nuk i mbajte të regjistruara pajisjet gjatë kohës kur p.sh., kamionët nuk janë të nevojshëm, dhe meqë si kërkesë e AK është që të gjitha pajisjet të jenë të regjistruara, kjo i kushton OE-ve deri në 10,000€ vetëm që të marrin pjesë në procesin e tenderimit. Do të ishte më mirë të kërkohej dëshmi e posedimit të pajimeve dhe të lejohej një periudhë për regjistrim p.sh., brenda 30 ditëve prej dhënies së kontratës”.

Vlen të potencohet se edhe pse në dosjen e tenderit Autoritet Kontraktues ka theksuar se e gëzon të drejtën e inspektimit dhe do të vizitojë vendpunishten e operatorëve ekonomik gjatë fazës së vlerësimit për të vërtetuar posedimin e kriterëve të detyrueshëm, nga qasja në dokumente publike, KDI-së i është ofruar kopje të raporteve të inspektimit të vendpunishteve vetëm pas nënshkrimit të kontratave me operatorët ekonomik.¹⁶ Siç do të diskutohet në seksionin pasues, pas inspektimit, pothuajse të gjithë operatorët ekonomik nuk i plotësojnë kriteret e detyrueshme. Në kushte normale, operatorët ekonomik të cilët nuk posedojnë pajisjet teknike dhe kërkesat minimale sipas dosjes së tenderit do duhet të diskualifikoheshin. KDI nuk ka pranuar asnjë raport në lidhje me inspektimin e vend punishteve gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

- Kërkesat e parapara me ligj në lidhje me nën kontraktimin e lejuar për kryerën e punëve.
- Kërkesat në lidhje më krijimin e një grupi të operatorëve ekonomik
- **Siguria e tenderit** - Shuma e Sigurimit të Tenderit duhet te jete 50,000.00 € për secilën pjesë / llot, me kohëzgjatje 120 ditë prej datës së pranimit të ofertave.
- **Siguria e ekzekutimit** – pas dhënies së kontratës dhe para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit në vlerën 10% të totalit të çmimit ofertues me kohëzgjatje për periudhën prej 30 ditësh pas përfundimit të kontratës.

Në grupin punues¹⁷ është vënë në pah se Autoriteti Kontraktues, “përveç sigurisë së ekzekutimit, i ndalon edhe nga 10% të vlerës së faturës si garanci të kualitetit, e cila po i dëmton shumë OE-të duke ju shkaktuar problem në qarkullim apo në likuiditet.”¹⁸

16 Në kërkesën për sqarim drejtuar drejtorit të departamentit të prokurimit, KDI ka hasur në një heshnje nga Ministria e Infrastrukturës.

17 KDI, Grupi Punues i mbajtur me datën 29.01.2016.

18 Po aty.



VLERËSIMI I KONTRATAVE PËR MIRËMBAJTJEN VERORE DHE DIMËRORE TË RRUGËVE NACIONALE DHE REGJIONALE

Siç është potencuar me lartë, në këtë tender kanë ofertuar gjithsej 33 operator ekonomik, pesëmbëdhjetë prej tyre kanë qenë të përgjegjshëm sipas raportit të komisionit vlerësues, dhe janë dhënë 14 kontrata operatorëve fitues sipas njoftimit për dhënien e kontratave në ueb-faqen e KRPP-së. Specifikacionet teknike janë të ndara për mirëmbajtje verore dhe mirëmbajtje dimërore. Për secilin regjion janë dhënë parallogaritë, kilometrat e sakta, njësitë, dhe sasisitë e njërive. Harta e më poshtme tregon në mënyrë të detajuar shtrirjen e rrugëve nëpër regjionet e Kosovës e paraparë sipas Ministrisë së Infrastrukturës.

Rrjeti rrugor që duhet të mirëmbahet me Llot-et e mirëmbajtjes:

Ndërsa Tabela 1 deshifron hartën e rrugëve në kilometra dhe përqindje për secilin regjion.


Në vazhdim do të analizohet oferta e secilit operatorë fitues dhe do të krahasohet me ofertuesi tjerë të cilët janë shpall të pa përgjegjshëm.

TAB. 01 DOSJA E TENDERIT - SPECIFIKIMET TEKNIKE

REGJIONET	Ferizaj "1"	Ferizaj "2"	Gjakova "1"	Gjakova "2"	Peja "1"	Peja "2"	Prishtina "1"	Prishtina "2"
Nacionale dhe Regjionale (km)	111.76	88.54	127.53	84.42	112.82	155.98	201.32	159.30
Përqindja: %	5.66	4.93	7.28	4.70	6.28	8.70	12.21	8.87

REGJIONET	Prizreni "1"	Prizreni "2"	Mitrovica "1"	Mitrovica "2"	Gjilani "1"	Gjilani "2"	Gjithsej
Nacionale dhe Regjionale (km)	149.85	101.86	150.12	116.57	123.58	111.58	1795.23
Përqindja: %	8.30	5.67	8.36	6.49	6.88	6.21	100%

FIG. 01 SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MIRËMBAJTJEN VERORE TË RRUGËVE NACIALE DHE REGJIONALE TË KOSOVËS PËR VITIN 2014/2015, PRISHTINË, QERSHOR, 2014





REGJIONI: PRISHTINA 1

Ministria e Infrastrukturës, me datën 19.11.2014, ka hyrë në një kontratë tre (3) vjeçare me Operatorin Ekonomik “Arbotec” Sh.P.K. për shërbimet e mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale të përfshira në Regjionin Prishtina 1. Kjo kontratë ka vlerën prej 1,140,116.74 €¹⁹ për tri vite performancë, ose totalin prej 632.98 €²⁰ për pozicionet e ofertuara (tash e tutje të adresuara si “Njësi”), për mirëmbajtjen e 201.32 kilometrave të rrugëve nacionale dhe regjionale Prishtina 1, gjatë sezonin verorë dhe dimërorë.

Kontrata e regjionit të Prishtinës 1 ka vlerën me të madhe financiare por gjithashtu edhe hapësirën më të madhe për mirëmbajtje krahasuar me regjionet tjera në Kosovë.

Për këtë llot kanë aplikuar vetëm dy operator ekonomik. Tabela e mëposhtme pasqyron ofertën financiare nga dy ofertuesit për këtë regjion.

TAB. 02 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – PRISHTINA 1

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total
1	ARBOTEC SH.P.K.	Performues i Kontrates	€ 352.41	€ 280.57	€ 632.98
2	Integral & Milenium Construction	OE i papërgjegjshëm	€ 199.11	€ 259.94	€ 459.05
Dallimi			€ 153.30	€ 20.63	€ 173.93

19 Njoftimi për dhënie të kontratës, MI-14-051-211, data 30.10.2014

20 Kontrata ndërmjet MI dhe Arbotec SH.P.K. MI/14/051/211, NI I kontratës 058/2014

 **GJETJET:**

Gjatë vlerësimit të ofertave, vetëm njëri OE është vlerësuar si i përgjegjshëm. Duke iu referuar Procesverbalit për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, OE “Integral & Milenium Construction”, edhe pse kishte aplikuar për dy pozicione (Prishtina 1 dhe Prishtina 2), për sa i përket pozicionit Prishtina 1 nuk është treguar i suksesshëm meqë nuk ka prezantuar me kapacitete të mjaftueshme për realizimin e projektit sipas Dosjes së Tenderit, respektivisht mjetet, stabilitetet dhe pajisjet teknike, mirëpo nuk specifikon se cilat pajisje apo kritere specifike nuk janë përbushur.

Oferta e ofruar nga “Integral & Milenium Construction” për Prishtina 1 ishte 173.93 € më e lirë se ajo e Arbotec, por që gjatë vlerësimit ishte diskualifikuar si jo e suksesshme. Në vijim, duke iu referuar po të njëjtit procesverbal për vlerësimin e ofertave, shohim se edhe OE “Arbotec” nuk i kishte përbushur të gjitha kriteret e kërkuara nga Dosja e Tenderit, respektivisht “Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale” duke mos prezantuar draft kontratën për sigurimin e vend punishtes, megjithatë komisioni vlerësues kishte konstatuar se ky dokument nuk ndikon substancialisht në aspektin tekniko financiar, dhe mund të dorëzohet para nënshkimit të kontratës.

Ajo që është shqetësuese është analizimi i raportit të inspektimit në terren i datës 12.02.2015, me ç’rast kompania (Arbotec) ishte inspektuar me datën 20.01.2015 dhe ishin ndërprerë inspektimet për të vazhduar me datën 02.02.2015. Kompania ishte inspektuar edhe një javë më parë por për shkaqe subjektive inspektimi ishte ndërprerë sipas raportit të inspektorit. Ky raport i datës 12.02.2015 thekson së “pas inspektimit dhe pas plotësimit të disa elementeve administrative me datën 05.02.2015, bazuar në inspektimin e javës së kaluar dhe të gjeturat” e inspektimit ka lëshuar një aktvendim për eliminimin e parregullsive si në vijim:

- Nuk posedon kushte të nevojshme për punën në bazën lokale për mirëmbajtjen dimërore dhe verore në zyrat ku janë të vendosur personeli dhe logjistika si: kompjuter, internet, printer etj. bazuar në kontratë;

- Nuk posedon kushte teknike adekuate sipas kontratës për mbulojën e kripës;
- Nuk posedon kushte teknike adekuate sipas kontratës për mbulojën e automjeteve.

Siç shihet nga ky raport, edhe OE i vlerësuar si i suksesshëm për këtë kontratë, kishte probleme me përbushjen e kërkesave teknike, dhe sikur inspektimi i punishtes të ishte kryer para nënshkimit të kontratës, Ministria e Infrastrukturs do të mund të bënte një vlerësim më të drejtë, dhe ndoshta të kursente 173.39 € për njësi, apo së paku të ofronte kushte të barabarta për rishikimin dhe përbushjen e kërkesave teknike për të dy Operatorët Ekonomik. Për shkak të parregullsive të identifikuara, ky proces i tenderimit do të duhej të ishte anuluar dhe ri-tenderuar, meqë asnjëri Operator Ekonomik nuk kishte përbushur të gjitha kriteret teknike.

Nëse aplikojmë një matematikë të thjeshtë ku vlera totale e kontratës përpjesëtohet me totalin për njësi, do të fitojmë € 1,140,116.74 / € 632.92 = 1,801.19 Njësi. Dallimi total ndërmjet ofertave do të ishte si në vijim: (shih tabelën 03).

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturs rezultojnë se për vitin 2015 kjo ministri, për gjashtë (6) situacione ka paguar vlerën totale prej 1,444,284.31€²¹ ndërsa nëse këtë punë do të kryente operatori ekonomik me çmim më të lirë buxheti i Kosovës do paguante 1,047,424.42 €. Nga kjo i bie se buxheti i Kosovës për këtë regjion për këtë periudhë kohore 2015 të kishte kursyer 396,859.89 €.

21 Raporti i Pagesave për MVD 2015

TAB. 03 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – PRISHTINA 1

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për Njësi	Total Njësi	Vlera totale e kontratës
1	ARBOTEC SH.P.K.	Performues i Kontrates	€ 632.98	1,801.19	€ 1,140,116.74
2	Integral & Milenium Construction	OE i papërgjegjshëm	€ 459.05	1,801.19	€ 826,835.90
Dallimi (1-2)			€ 173.93	1,801.19	€ 313,280.84

Situacioni	Data e pagesës	Vlera pagesës
1	13.02.2015	€ 260,987.79
2	16.04.2015	€ 257,365.52
3	20.05.2015	€ 199,283.31
4	12.06.2015	€ 360,636.20
5	15.07.2015	€ 217,567.05
6	20.10.2015	€ 148,444.44
Vlera totale e pagesave		€ 1,444,284.31

Gjithashtu, vlera totale e kësaj kontrate është 1,140,116.74 €. Nga raporti i pagesave, shohim se vetëm deri më 20.10.2015 janë paguar 1,444,284.31 € që është 26.4% mbi vlerën e kontratës. Ligji për Prokurim Publik, Neni 35, thotë se procedurat e negociuara mund të përdoren për aneks kontrata në vlerë jo më të madhe se 10% nga vlera fillestare e kontratës.

Në këtë regjion nuk kishte ankesa të deponuar në OShP.

Me datën 30 Dhjetor 2015, KDI kishte parashtruar pranë Ministrisë së Infrastrukturës kërkesën për qasje në dokumentet zyrtare (Programin e Punës së Kontraktuesit dorëzuar Menaxherit të Projektit; Raportet

e menaxhimit të kontratave (performanca, kontrollit të kualitetit dhe çështjeve tjera në lidhje me zbatimin e kontratës deri me tani) – për të gjithë 14 kontratat; Raportet e Kontraktuesit të pranuar dhe aprovuara nga menaxheri i kontratës për pagesa mujore ose punëve të realizuara që nga nënshkrimi i kontratave deri më 1 dhjetor 2015; Dëshmi të ndëshkimeve/ gjobave ndaj Operatorëve Ekonomik nëse aplikohet) dhe deri më tani nuk është pranuar një përgjigje nga MI.

Në mungesë të qasjes në dokumente publike, ishte e pamundur që të krahasohen çmimet e ofruar nga operatorët ekonomik në raport me punët e realizuara. Kjo do të bënë të mundur vlerësimin e saktë për çmimet e pozicioneve që kanë ofertuar dhe punët që janë kryer. Po ashtu do të ishte e mundur që më precizitet të dihet sa ka mundur të kursehet buxheti për shërbimet e kryera sipas pozicioneve të faturuara.



REGJIONI: PRISHTINA 2

Në regjionin e Prishtina 2 kompania fitues është shpallur operator ekonomik “Integral Sh.P.K & Milenium Kostruction” Sh.P.K. Vlera e kontratës për shërbimet e këtij operatori është 876,781.48 €²² ose 459.73

€²³ për njësi për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të 159.30 kilometra rrugë. Për këtë regjion kanë aplikuar gjithsej pesë operatorë ekonomik, me çmimin për njësi si në tabelën 4:

TAB. 04 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – PRISHTINA 2

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	INTEGRAL SH.P.K & MILENIUM KOSTURCTION SH.PK	Performues i Kontrates	€ 199.75	€ 259.98	€ 459.73	€ 0.00
2	Jaha Company & TOIFOR Prishtine	OE i papërgjegjshëm	€ 116.43	€ 87.16	€ 203.59	€ (256.14)
3	CONEX GROUP & ITK-Prishtinë	OE i papërgjegjshëm	€ 145.99	€ 162.25	€ 308.24	€ (151.49)
4	ARBOTEC sh.p.k	OE i papërgjegjshëm	€ 330.60	€ 275.36	€ 605.96	€ 146.23
5	VAKAL	OE i papërgjegjshëm	€ 439.34	€ 436.96	€ 876.30	€ 416.57

²² Njoftimi për dhënie të kontratës, MI-14-051-211, data 30.10.2014

²³ Kontrata ndërmjet MI dhe Integral Sh.P.K. & Milenium Construction MI/14/051/211, NI i kontratës 072/2014

 **TAB. 05**

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për Njësi	Total Njësi	Vlera totale e kontratës
1	INTEGRAL SH.P.K & MILENIUM KOSTURCTION SH.PK	Performues i Kontrates	€ 459.73	1,907.17	€ 876,781.48
2	Jaha Company & TOIFOR Prishtine	OE i papërgjegjshëm	€ 203.59	1,907.17	€ 388,279.95
3	CONEX GROUP & ITK-Prishtinë	OE i papërgjegjshëm	€ 308.24	1,907.17	€ 587,864.88
4	ARBOTEC sh.p.k	OE i papërgjegjshëm	€ 605.96	1,907.17	€ 1,155,666.38
5	VAKAL	OE i papërgjegjshëm	€ 876.30	1,907.17	€ 1,671,249.67

Nëse aplikojmë një matematikë të thjeshtë ku vlera totale e kontratës përpjesëtohet me totalin për njësi, do të fitojmë 876,781.48 € / 459.73€ = 1,907.17 Njësi. Dallimi total ndërmjet ofertave do të ishte si në vijim: (shih tabelen 05)

 **GJETJET:**

Duke iu referuar Procesverbalit për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, OE "INTEGRAL Sh.P.K. & MILENIUM KOSTURCTION Sh.P.K.", ishte vlerësuar si operatori me ofertën më të lirë të përgjegjshme për Regjionin Prishtina 2. Sipas po të njëjtit procesverbal, katër (4) OE-të tjera ishin të papërgjegjshme për arsyet si në vijim:

Jaha Company & TOIFOR Prishtinë – kishte ofertuar për dy Lloje Gjilani 2 dhe Prishtina 2. Për sa i përket regjionit Prishtina 2, komisioni kishte vlerësuar se ky operator nuk dispononte me pajisje të mjaftueshme për realizimin e projektit, sipas kërkesës me dosjen e tenderit te pika C, ku kërkohen mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë obligative për secilin Llot veç e veç.

CONEX GROUP & ITK-Prishtinë – Kishte ofertuar vetëm për një llot, atë të Prishtina 2, mirëpo komisioni kishte vlerësuar se ishte një ofertë e papërgjegjshme sepse nuk kishte plotësuar kushtet teknike për mjetet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e punëve, si dhe oferta ishte ngatërruar me specifikat e kërkuara për regjionin Ferizaj 1, respektivisht ka mungesë për dy (2) kamion dhe dy (2) shpërndarëse bore ku janë kërkuar për regjionin Prishtina 2: 7 kamion dhe 7 plugje, ndërsa OE ka ofruar nga 5 kamion dhe 5 plugje."

ARBOTEC sh.p.k – Kishte ofertuar për Regjionet Prishtina 1 dhe Prishtina 2, mirëpo, sa i përket regjionit Prishtina 2, komisioni kishte vlerësuar se ky OE ishte treguar jo i suksesshëm meqë nuk kishte plotësuar kriterin mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek stafi teknik për udhëheqjen e këtij projekti, me ç'rast menaxheri i projektit i përcaktuar për këtë llot nuk i plotëson kushtet e kërkuara si dëshmia/referenca për punët e kryera të lëmisë së kërkuar, si dhe inxhinieri i njëjtë i gjeodezisë është paraparë në të dy llotet e ofertuara, që do të thotë se nuk posedojnë stafin e mjaftueshëm të kërkuar për këtë llot.

VAKAL Company & Murseli – ishte vlerësuar si i pa-suksesshëm meqë nuk kishte arritur t'i plotësoj kushte

të shumta të kërkuara si kompletimi i dokumentacionit të tenderit, mungesa e raporteve financiare, mungesa e munësive teknike dhe profesionale, licencat dhe pasqyrat tatimore.

Ajo që është shqetësuese në lidhje me këtë vlerësim, është se nga Raporti i Inspektoratit Rrugor, i datuar 12.02.2015 shohim se nga inspektimi i OE "INTEGRAL Sh.P.K & MILENIUM KOSTURCTION Sh.PK" i bërë me datën 20.01.2015, me qëllim të verifikimit të gjendjes së zyrës, administratës, dhe mjeteve teknike për mirëmbajtje dimërore dhe verore bazuar në planin operativ Janar-Shkurt 2015, inspektorati ka lëshuar vendim për eliminimin e të gjeturave si më poshtë:

- 1 Nuk posedon dosjen e personelit për:
 - Menaxherin e punishtes dhe mirëmbajtjes me kualifikime adekuate,
 - Kontratat dhe kualifikimet e vozitësve
- 2 Nuk posedon urdhëresat e rrugës-ditore për automjetet dhe shoferet
- 3 Nuk posedon certifikatën e tahografit për automjete (kamion)
- 4 Nuk posedon edhe dy (2) automjete (kamion) sipas kontratës
- 5 Nuk posedon kushte teknike adekuate sipas kontratës

Nga pikëpamja e kriterëve tenderuese, i bje se në raportin e vlerësimit të këtij OE figuron se i posedon këto kritere por gjate inspektimeve nuk janë gjetur se i përmbush këto kritere:

- Menaxheri i projektit të jetë ing. i dipl. 3-vite përvojë pune pas diplomimit – të këtë dëshmi për se paku dy (2) projekte te menaxhuar te lëmisë se kërkuar (CV, diploma, kontrata, dhe letër reference për punët e kryera)

- Dokumentet e udhëheqësit te punishtes
- Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit
- Shoferet e kamionëve 6 tonesh te pajisur me kategorinë C

Nga ky raport shohim se OE i shpërblyer me kontratë nuk ka treguar sinqeritet afarist në ofertën e tij rreth përmbushjes së kriterëve teknike dhe profesionale dhe ky mos sinqeritet, si dhe mungesa e inspektimit para dhënies së kontratës, i kanë kushtuar buxhetit të Kosovës shumën e përafërt prej 488,501.53 € më shumë se sikur kontrata t'i ishte dhënë Jaha Company & Toifor, apo 288,916.60 € nëse kontrata do t'i ishte dhënë CONEX Group & ITK, ku të dy kompanitë ishin diskualifikuar për mos përmbushjen e kriterëve teknike dhe profesionale.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturës rezulton se për vitin 2015 kjo ministri, për gashtë (6) situacione ka paguar vlerën totale prej 868,237.75€, ndërsa nëse këtë punë do të kryente operatori ekonomik që kishte ofertuar çmimin më të lirë, buxheti i Kosovës do paguante 384,946.38 €. Nga kjo shohim se buxheti i Kosovës për këtë regjion për këtë periudhë kohore do të kishte kursyer 483,741.36 € sikur kontrata t'i ishte dhënë Jaha Company, apo 286,101.27 € sikur kontrata t'i ishte dhënë Conex Group.

Ndërkohe OE CONEX GROUP & ITK-Prishtinë ishte ankuar edhe pse ankesa e saj ishte refuzuar siç mund të vërehet në seksionin e ankesave.



REGJIONI: PRIZRENI 1

Ministria e Infrastrukturës kishte hyrë në kontratë me “Famis Co Holding Company” Sh.A si të vetmin ofertues të përgjegjshëm për këtë llot, me çmimin për njësi prej 1,239.98 €²⁴, dhe totalin e kontratës së nënshkruar 738,732.92 € për mirëmbajtjen e 149.85 kilometra rrugë gjatë sezonit verorë dhe dimërorë të parapara sipas dosje së tenderit. Për këtë regjion kishin ofertuar vetëm dy Operator Ekonomik.

Nëse aplikojmë një matematikë të thjeshtë ku vlera totale e kontratës përpjesëtohet me totalin për njësi, do të fitojmë $738,732.92\text{€} / 1,239.98\text{€} = 595.76$ Njësi. Atëherë, dallimi total ndërmjet ofertave do të ishte si në vijim:

●● TAB. 06 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – PRIZRENI 1

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total
1	Famis Co Holding Company Sh.A	Performues i Kontrates	€ 696.43	€ 543.55	€ 1,239.98
2	Drini Company sh.p.k	OE i papërgjegjshëm	€ 92.80	€ 83.57	€ 176.37
Dallimi (1-2)			€ 603.63	€ 459.98	€ 1,063.61

24 Kontrata ndërmjet MI dhe Famis CO Holding Company SHA - MI/14/051/211, NI I kontratës 055/2014

●● **TAB. 07**

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për Njësi	Total Njësi	Vlera totale e kontratës
1	Famis Co Holding Company Sh.A	Performues i Kontrates	€ 1,239.98	595.76	€ 738,732.92
2	Drini Company sh.p.k	OE i papërgjegjshëm	€ 176.37	595.76	€ 105,074.54
Dallimi (1-2)			€ 1,063.61	595.76	€ (633,658.38)

●● **GJETJET:**

Duke iu referuar Procesverbalit për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, OE “Drini Company”, ishte vlerësuar si operatori i pa suksesshëm për llotin Regjioni i Prizrenit 1, nën arsye se nuk i kishte përmbushur kriteret e kërkesave të detyrueshme profesionale, megjë udhëheqësi i përcaktuar për këtë llot nuk kishte dëshmi/referenca të mjaftueshme mbi përvojën e punës si udhëheqës i minimum dy projekteve të realizuara në lëmine e kërkuar.

Diferenca e çmimeve të ofruara nga këta dy operator ekonomik është diametralisht e kundërt, dhe KDI nuk ka hasur në ndonjë dëshmi ku Ministria e Infrastrukturës ka kërkuar nga Operatorët ekonomik të arsyetojnë çmimet jo normalisht të ulëta apo edhe ato jo normalisht të larta. Në raportin e inspektimit nga Ministria e Infrastrukturës, të datës 12.02.2015 nuk kishte asnjë vërejtje, edhe pse, pothuajse në të gjitha regjionet tjera ishin gjetur mangësi të shumta. Në realitet krejt ky rregullim duket shumë i dyshimtë i cili duket të ngjanë më kategorinë e kurdisjes së tenderëve për Regjionin e Prizrenit, ku këto dy lloje performohen nga kompanitë në fjalë. Kjo paraqet një brengje të madhe sidomos në faktin se OE “Famis” fituese e Prizrenit 1, ishte vlerësuar si e pasuksesshme në llotin Prizreni 2, për arsye pothuajse të njëjta me Drini Company, respektivisht mos përmbushja e kriterëve të kërkuara profesionale.

Në të kaluarën kur ishte vetëm një llot në regjionin e Prizrenit sipas raportit të KDI-së së vitit 2014,²⁵ këto dy kompani kishin ushtruar ankesë kundra njëra tjetrës. Tani ndarja e Prizrenit në dy regjione, duket të jetë rregullim perfekt për ndarjen e interesit nga këto dy kompani. Po ashtu, edhe ne OShP nuk është deponuar asnjë ankesë lidhur me procesin e tenderimit për këtë regjion.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturës rezulton se deri më 20.10.2015 kjo ministri, për pestë (5) situacione ka paguar vlerën totale prej 708,211.52 € ndërsa nëse këtë punë do të kryente operatori ekonomik me çmim më të lirë buxheti i Kosovës do paguante 100,733.29 €, respektivisht, për këtë regjion për këtë periudhë kohore të ishin kursyer 607,478.23 €.

25 KDI (Mars, 2014), Prokurimi Publik në Ministrinë e Infrastrukturës, faqe 18-19.



REGJIONI: PRIZRENI 2

Njëjtë si për regjionin e më sipërm, edhe për regjionin Prizreni 2, kishin ofertuar vetëm dy Operator Ekonomik. Operatori ekonomik “**Drini Company**” sh.p.k ka ofruar çmim më të lirë për njësi prej 173.37 EURO²⁶. Ndërsa, totali i kontratës së nënshkruar është 511,627.53 EURO për mirëmbajtjet e 101.86 kilometra rrugë gjatë sezonit verore dhe dimërore.

Nëse aplikojmë një matematikë të thjeshtë ku vlera totale e kontratës përpjesëtohet me totalin për njësi, do të fitojmë $511,627.53\text{€} / 1,239.98\text{€} = 2,951.07$ Njësi. Atëherë, dallimi total ndërmjet ofertave do të ishte si në vijim:

●● TAB. 08 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – PRIZRENI 2

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total
1	Drini Company sh.p.k	Performues i Kontrates	€ 92.80	€ 83.57	€ 173.37
2	Famis Co Holding Company Sh.A	OE i papërgjegjshëm	€ 696.43	€ 543.55	€ 1,239.98
Dallimi			€ 603.63	€ 459.98	€ 1,066.61

26 Kontrata ndërmjet MI dhe Drini Company - MI/14/051/211, NI I kontratës 057/2014

TAB. 09

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për Njësi	Total Njësi	Vlera totale e kontratës
1	Drini Company sh.p.k	Performues i Kontrates	€ 173.37	2,951.07	€ 511,627.53
2	Famis Co Holding Company Sh.A	OE i papërgjegjshëm	€ 1,239.98	2,951.07	€ 3,659,271.53
Dallimi (1-2)			€ (1,066.61)	2,951.07	€ (3,147,644.00)

Njëjtë si në rastin e Regjionit Prizreni 1, KDI nuk ka hasur në ndonjë dëshmi ku Ministria e Infrastrukturaës ka kërkuar nga Operatorët ekonomik të arsyetojnë çmimet jo normalisht të ulëta apo edhe ato jo normalisht të larta. Problemi me çmimet jo normalisht të ulëta është shprehur edhe si brengë e Operatorëve Ekonomik, gjatë grupit punues të organizuar nga KDI, me 29 janar, lidhur me brengat dhe gjetjet e këtij raporti²⁷.

GJETJET:

Gjetja e parë në këtë regjion është diskrepanca ndërmjet çmimit për njësi nga oferta e Operatorit Ekonomik, dhe çmimi i kontratës, ku kemi një dallim prej tre (3) Euro më pak në kontratë. Në totalin e kontratës së nënshkruar, kjo diskrepancë reflekton si një ulje prej 8,853.22 € kundrejt ofertës së pranuar.


Për dallim nga disa regjione, numri i prokurimit i cekur në sigurimin e ekzekutimit të tenderit është në përputhje me numrin e prokurimit në kontratë. Edhe nga inspektim i bërë nga inspektori i Ministrisë së Infrastrukturaës, me datën 30.01.2015 thekson se “kompania në fjalë nuk kishte asnjë vërejtje sa i përket kushteve

administrative dhe teknike bazuar në kontratë”. Në tjetrën anë thekson se “gjetjet e inspektimit janë të përshkruar në procesverbalin me numër të procesverbalit 007873,007874, 007875, dhe pas tri dite menaxheri i subjektit ka sjellë në zyrë në Prishtinë disa nga dokumentet të cilat nuk ishin në momentin e inspektimit në bazën lokale por në zyre në seli”.

Në lidhje me arsyet e shpalljes si të pa përgjegjshëm të OE “Famis Co” për këtë llot, i cili është shpallur i përgjegjshëm për regjionin Prizreni 1, komisioni vlerësues thekson “nuk është treguar i suksesshëm sepse stafin teknik udhëheqës për këtë projekt nuk e ka ndarë në secilin llot por vetëm i përcakton për projekt (të përbashkët), që do të thotë se nuk i plotëson kushtet që nëse oferta përmban më shumë lloje duhet të rritet personeli në varësi të numrit të llojeve”.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturaës rezulton se deri më 20.10.2015 kjo ministri, për pesë (5) situacione ka paguar vlerën totale prej 659,000.47 €, përderisa oferta e Famis do të kishte kushtuar 4,713,314.89 €.

27 Operatorët ekonomik pjesëmarrës në grupin punues të datës 29 Janar 2015 theksojnë, “OE nuk po tregohen të sinqerta duke ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta në artikujt që nuk konsumohen shpesh, p.sh., 0.1€ për shenjë të komunikacionit, të cilat veç janë të vendosura, dhe ofertojnë me çmime të larta në artikujt që shfrytëzohen më shumë, por në totalin e ofertuar për njësi dalin si më të ulët. P.sh, mirëmbajtja e rrugëve në Viti ka kushtuar 32,000€ më shumë, për shkak të këtij lloji të ofertave dhe mos menaxhimit të sasive.”



REGJIONI: FERIZAJ 1

Për regjionin e Ferizaj 1, Ministria e Infrastrukturës ka hyrë në kontratë me Operatorin Ekonomik “Eurokos & VIA” Sh.P.K me çmimin për njësi prej 561.31 €²⁸, dhe

totalin e kontratës në vlerë prej së nënshkruar është 550,952.81 € për mirëmbajtjet e 111.76 kilometra rrugë gjatë sezonit veror dhe dimëror.

TAB. 10 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – ERIZAJ 1

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	“Eurokos & VIA” sh.p.k	Performues i Kontrates	€ 406.35	€ 154.96	€ 561.31	€ 0
2	Eskavatori	OE i papërgjegjshëm	€ 940.55	€ 619.54	€ 1,560.09	€ 998.78
3	Kastrioti & Ledi	OE i papërgjegjshëm	€ 1,212.89	€ 756.83	€ 1,969.72	€ 1,408.41
4	RSM & Joos Krasniqi Bazë	OE i papërgjegjshëm	€ 1,074.27	€ 631.63	€ 1,705.90	€ 1,144.59




28 Kontrata ndërmjet MI dhe EUOKOS sh.p.k. & VIA sh.p.k. - MI/14/051/211, NI I kontratës 071/2014

GJETJET:

Nga analizimi i dokumenteve dhe vlerësimeve të komisionit vlerësues duket se tre (3) ofertuesit tjerë nuk kanë qenë aspak serioze në ofertat e tyre duke pasur parasysh se ofertat me çmime shumë të larta si dhe mos përbushjes së kriterëve teknike dhe profesionale, të kërkuara në dosjen e tenderit.

ciuara mund të përdorën për aneks kontrata në vlerë jo më të madhe se 10% nga vlera fillestare e kontratës, edhe pse KDI nuk është njoftuar për ndonjë kontratë shtesë për këtë aktivitet.


Megjithatë, vlen të theksohet se operatorit ekonomik fitues gjatë inspektimit të datës 03.02.2015 në terren rezultoi se nuk i ka përbushur kushtet si më poshtë:

-  **1** Nuk posedon urdhëresat e rrugës – ditore për automjete dhe shoferët;
-  **2** Nuk posedon certifikatën e tahografit për automjete (kamion);
-  **3** Nuk posedon kushte teknike adekuate sipas kontratës për mbulojën e kripës.

Operatori Ekonomik i shpërblyer më kontratë ka ofruar çmimin më të lirë dhe i ka plotësuar kriteret me së miri, me gjithë pa rregulluesit e gjetura me vonë. Pra, edhe nëse inspektimi në terren do ishte bërë para dhënies së kontratës, gjasat për rekomandim të ndonjë operatori tjetër për t'i dhënë kontratë janë minimale për shkak të çmimit më të lartë dhe mungesës së plotësimit të kriterëve.

Në këtë llot operatori i tretë i radhitur në tabelë më lartë, ka ushtruar të drejtën e tij të ankesës në OShP por siç mund të shihet në seksionin e trajtimit të ankesave, ankesa e këtij operatori ekonomik ishte pranuar vetëm pjesërisht.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturës rezultoi se deri më 20.10.2015 kjo ministri, për shtatë (7) situacione ka paguar vlerën totale prej 862,685.91 €. Vlera totale e kësaj kontrate është 550,952.81 €, që do të thotë se deri me datën e paracekur, MI ka paguar 311,733.10 € (57% të vlerës së kontratës), më shumë. Ligji për Prokurim Publik, Neni 35, thotë se procedurat e nego-



REGJIONI: FERIZAJ 2

Në regjionin e Ferizaj 2, kontrata i është dhënë operatorit ekonomik “Damastion Project” Sh.P.K, të përgjegjshëm i cili ka ofertuar me çmim më të lirë për njësi prej 1,453.58 €²⁹. Ndërsa, totali i kontratës së nën-

shkruar është 486,567.24 € për mirëmbajtjen e 88.54 kilometra rrugë gjatë sezonit verorë dhe dimërorë të paraparë sipas dosjes së tenderit.

TAB. 11 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – FERIZAJ 2

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	“Damastion Project” sh.p.k	Performues i Kontrates	€ 1,204.67	€ 248.91	€ 1,453.58	€ 0.00
2	RSM & Joos Krasniqi Bazë	OE i papërgjegjshëm	€ 82.96	€ 129.36	€ 212.32	€ (1,241.26)
3	Shkoza F07 & Papanburg+ Adriani	OE i papërgjegjshëm	€ 398.58	€ 568.96	€ 967.54	€ (486.04)
4	Eskavatori	OE i papërgjegjshëm	€ 669.02	€ 327.00	€ 996.02	€ (457.56)
5	Kastrioti & Ledi	OE i papërgjegjshëm	€ 1,124.73	€ 598.21	€ 1,722.94	€ 269.36

29 Kontrata ndërmjet MI dhe Damastion Project. - MI/14/051/211, NI I kontratës 067/2014

GJETJET:

Parregullsia e parë në këtë kontratë është në lidhje me sigurimin e ekzekutimit. Sikur në disa regjione tjera edhe këtu, numri i prokurimit është i cekur gabimisht në vend se të jetë MI/14/051/211, numri i gabuar është MI/13/051/211. Sipas procesverbalit të vlerësimit të ofertave, operatori ekonomik RSM & Joos Krasniqi Bazë, i cili ka ofertuar me lirë për njësi për hiq me pak se 1,241.26 €, nuk ka bërë noterizimin e kontratës së menaxherit të projektit si dhe nuk është në listën e ATK-së për vitin 2014.

Ndërsa, operatori ekonomik “Eskavatori” kishte mungesë të përvojës së punës relevante për inxhinierin e komunikacionit, mungesë e numrit të personelit dhe patentë shoferit për kategorinë C, si dhe mungesa e licencës për prodhimin e betonit ani se ka marrëveshje bashkëpunimi për beton.

Operatori Ekonomik Shkoza F07 & Papenburg & Adriani, ka ofertuar me çmim me të lirë për 486.04 €. Ndërsa shkaqet e deklarimit të sajë si të pa përgjegjshëm ishin sepse kishte ofertuar për katër lloje dhe stafin e kishte ndarë në variante duke e paraqitur të njëjtin inxhinier në pozitë të ndryshme për lloje, si dhe të mjetet “stabilimentet dhe pajisjet teknike kompania “Shkoza F07” nuk ka bërë noterizimin e listës së pajisjeve të dhënë në dosjen e tenderit, por ka noterizuar një listë të veten të pajisjeve të ndarë në lloje”.³⁰

Në raportin e Inspektorit të Infrastrukturaës Rrugore, që mban datën 12.02.2015, theksohet se gjatë inspektimit në terren të operatorit ekonomik “Damastion – Project” Sh.P.K, me datën 06.02.2015 u gjetën pa rregullsitë e shënuara me poshtë:

- 1** Posedon urdhëresat e rrugës – ditore për automjetet, mirëpo duhet që t'i vendos në funksion që secili shofer të jetë me urdhëresa ditore;
- 2** Posedon kamion, përveç vetëm një është me i vogël se sa është i paraparë në kontratë ;
- 3** Hangari për vendosjen e kripës është në përfundim e sipër.

Nëse behët aplikimi i kriterëve në mënyrë strikte i bie së ky regjion është dashur të anulohet dhe tenderi të ri-shpallet.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturaës rezulton se për vitin 2015 kjo ministri, për shatë (7) situacione ka paguar vlerën totale prej 748,015.35 €, ndërsa nëse këtë punë do të kryente operatori ekonomik i renditur i pari me çmim më të lirë buxheti i Kosovës do paguante 109,260.32 €. Kjo i bje se buxheti i Kosovës për këtë regjion për këtë periudhë kohore do të ishte kursyer për 638,755.03 €.

Ndërsa nëse këtë punë do të kryente operatori ekonomik i renditur i dyti me çmim më të lirë buxheti i Kosovës do të paguante 497,898.14 €. Kjo i bje se buxheti i Kosovës për këtë regjion për këtë periudhë kohore të ishte ruajtur 250,117.21 €.

Njëjtë sikur në rastin e Regjioneve Prishtina 1 dhe Ferizaj 1, vlera totale e kësaj kontrate është 486,567.24 €, që do të thotë se deri me datën e 16.10.2015, MI ka paguar 261,448.11 € (54% të vlerës së kontratës), më shumë. Ligji për Prokurim Publik, Neni 35, thotë se procedurat e negociuara mund të përdoren për aneks kontrata në vlerë jo më të madhe se 10% nga vlera fillestare e kontratës, edhe pse edhe në këtë rast KDI nuk është njoftuar për ndonjë kontratë shtesë për këtë aktivitet.

30 Raporti i Komisionit vlerësues, faqe 22.



REGJIONI: GJAKOVA 1

Sa i përket regjionit Gjakova 1, gjithsej kanë aplikuar pesë (5) operator ekonomik, ndërsa operatori ekonomik **Victoria Invest International Sh.P.K.**, është shpërblyer me nënshkrim të kontratës në vlerë prej 1,215.66 €³¹ për Njësi, apo 487,022.61 € për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të 127.53 kilometrave. Ndërsa për njësi Min-

istria e Infrastrukturës paguan shumë prej 1,215.66 €. Nëse i krahasojmë me ofertuesit tjerë paraqitur si në tabelën me poshtë, në kolonën e renditjes mund të vërehet së OE i shpërblyer më kontrate është i treti në radhë sipas çmimit.

TAB. 12 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – GJAKOVA 1

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	VICTORIA INVEST INTERNATIONAL SH.P.K	Performues i Kontrates	€ 695.30	€ 486.86	€ 1,182.16	€ 0.00
2	PE-VAL-KU	OE i papërgjegjshëm	€ 679.41	€ 279.84	€ 959.25	(€ 222.91)
3	ASFALTI SH.P.K	OE i papërgjegjshëm	€ 399.62	€ 884.15	€ 1,283.77	€ 101.61
4	RSM COMPANI SH.P.K	OE i papërgjegjshëm	€ 1,050.84	€ 743.67	€ 1,794.51	€ 612.35
5	Alb Shpresa & Malësia	OE i papërgjegjshëm	€ 700.70	€ 814.43	€ 1,515.13	€ 332.97

31 Kontrata ndërmjet MI dhe Victoria Invest International Sh.P.K. - MI/14/051/211, NI i kontratës 066/2014



Shpallja e fituesit të operatorit ekonomik siç ka vepruar komisioni vlerësues përmban në vete edhe absurditetin e tij. Operatori fitues në ofertën e tij financiare nuk i ka vendos fare çmimet për disa pozicione, respektivisht për pozicionet (verore) 4.3, 4.4, 5.1, 5.3, 6.6. Ky veprim i komisionit vlerësues është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

Ofertës financiare të operatorit fitues, po ashtu i mungon llogaritja për njësi. Në kontratën e firmosur, në mes të OE dhe AK, çmimi për njësi figuron si: **1,215.66 €**. Ndërsa nëse i kalkulojmë çmimet e paramasave të dhëna për njësi del se shuma totale për njësi është **1,182.16 €**. Nga kjo del se çmimi i kontratës është nënshkruar për **33.50 €** më shtrenjtë nga ajo që është ofertuar.

I njëjti operator ekonomik fitues kishte aplikuar për regjionin Gjakova 2, dhe në ofertën e tij financiare nuk i kishte munguar vendosja e çmimeve për asnjë pozicion. Dyshimi është se disa pozicione janë lënë qëllimisht të pa plotësuar dhe me vone janë futur në llogari të kontratës, andaj është rritur çmimi pasi që është fituar kontrata. Kjo është një formë që mund të konsiderohet si formë tipike e keqpërdorimit që shpesh ndodh në procedurat tenderuese.

Sipas komisionit vlerësues Operatorit Ekonomik **PE-VAL-KU & ALBA VIA** i mungon licenca e Auditorit për raportin e vitit 2011. OE Alba VIA i mungon raporti i auditorit për vitin 2013 të pasqyrave financiare, si dhe nuk ka paraqit dëshmi të mjaftueshme për në lidhje me kërkesën e gjendjes ekonomike për realizimin e projektit – mbështetje nga banka ose anekses në vlerë së paku 20% të vlerës së ofertës.

Në Raportin e Inspektoratit të operatorit fitues, përpiqur nga inspektori i Infrastrukturrës Rrugore me datën 12.02.2015 tregon se nga inspektimi i bërë me datën 28.01.2015 dhe 04.02.2015 me numër të procesverbalit: 009963 dhe 009967. Më qëllim të verifikimit të gjendjes së zyrës, administratës, dhe mjeteve teknike

për mirëmbajtje dimërore dhe verore bazuar në planin operativ Janar-Shkurt 2015, inspektorati vjen në përfundim se “Kompania në fjalë nuk disponon me të gjitha elementet përmbajtjesore, me të cilat i përmbush kriteret në bazë të kontratës që ka me MI. Mangësitë sipas kontratës janë si në vijim:

- Zyrën e stafit
- Pesë (5) kamion i ka me targa të Elbasanit nga gjithsej gjashtë (6) që duhet ti ketë sipas kontratës.

Përfundimi është se edhe për këtë regjion, inspektimi në terren është dashur të behët para nënshkrimit të kontratës (neve nuk na është dhënë ndonjë informata nëse komisioni vlerësues ka bërë inspektim paraprak) dhe kësisoj operatorit ekonomik me çmim me të lire do të kishte mundësi të barabartë për sjelljen e dokumentacionit.

OE “Alb Shpresa & Malësia” kishte ushtruar të drejtën e ankesës në OShP por për shkak se ishte vërtetuar se i njëjti operator ka problem me ligjin, ankesa e tij ishte refuzuar siç është diskutuar më në detaje në komponentin e trajtimit të ankesave.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturrës rezultojnë se për vitin 2015 kjo ministri, për dy (2) situacione, deri më datën 04.06.2015 ka paguar vlerën totale prej 75,403.02 €, ndërsa nëse këtë punë do të kryente operatori ekonomik i renditur i pari me çmim më të lirë buxheti i Kosovës do paguante 59,498.82 €. Kjo i bje se buxheti i Kosovës për këtë regjion për këto situacione të ishte kursyer për 15,904.20 €.





REGJIONI: GJAKOVA 2

Për Regjionin Gjakova 2, operatori ekonomik fitues është “**R.S.M sh.p.k & JOOS KRASNIQI BAZE**” sh.p.k - Prishtinë/JUNIK, i shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktues pas vlerësimit dhe rekomandimit të komisionit vlerësues. Vlera e kontratës është 641,017.98 € dhe vlera e shumës për njësi është 184.74 €³² për

mirëmbajtjen e 84.42 kilometra rrugë. Për këtë regjion kanë aplikuar katër (4) Operatorë Ekonomik, dhe pasqyra e ofertave të tyre është paraqitur në tabelën në vijim:

TAB. 13 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – GJAKOVA 2

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	R.S.M sh.p.k & JOOS KRASNIQI BAZE sh.p.k	Performues i Kontrates	€ 68.35	€ 116.39	€ 184.74	€ 0.00
2	Victoria Invest International	OE i papërgjegjshëm	€ 749.24	€ 521.50	€ 1,270.74	€ 1,086.00
3	Shkoza F07 & Popenburg Ardiani	OE i papërgjegjshëm	€ 534.63	€ 461.39	€ 996.02	€ 811.28
4	Drini Company	OE i papërgjegjshëm	€ 92.80	€ 83.57	€ 176.37	(€ 8.37)

32 Kontrata ndërmjet MI dhe R.S.M sh.p.k & JOOS KRASNIQI BAZE sh.p.k. - MI/14/051/211, NI i kontratës 069/2014

GJETJET:

I njëjti operator ekonomik fitues për këtë regjion, ishte shpallur i pa përgjegjshëm për regjionet Gjakova 1, Ferizaj 1 dhe Ferizaj 2. Ndër të tjera komisioni vlerësues potencon se ka OE “nuk ka noterizuar listën e dosjes së tenderit (vetëm ka plotësuar për secilin lot), mirëpo një listë të veten të cilën e ka noterizuar nuk e ka ndarë në lloje” pra nuk e ka specifikuar se për cilin lot e ka noterizuar këtë listë “dhe komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit konstatoi se posedon pajisje vetëm për një llot”. Kjo qasje e komisionit është diskriminues në raport me operatorët tjerë ekonomik pasi që në disa raste dokumente të ngjashme nuk janë pranuar pa e specifikuar se për cilin llot apo kontratë dedikohet p.sh. marrëveshja me inxhinier por pa e përcaktuar se për cilin tender bëhet fjalë nuk pranohet. Ndërsa operatorit ekonomik fitues në regjionin Gjakova 1, është në të njëjtën kohë edhe OE ankues në këtë regjion, në tabele të renditjes të katërti më radhë për çmimin e njësisë. Por siç vërehet në komponentin e ankesave sipas OShP-s ishte pjesërisht e bazuar.

Në Raportin e Inspektoratit të operatorit fitues, përpiluar nga inspektori i Infrastrukturës Rrugore me datën 12.02.2015 tregon se nga inspektimi i bërë me datën 28.01.2015, me numër të procesverbalit: 009962, me qëllim të verifikimit të gjendjes së zyrës, administratës, dhe mjeteve teknike për mirëmbajtje dimërore dhe verore bazuar në planin operativ Janar-Shkurt 2015, thekson se kompania mirëmbajtëse “RSM Sh.P.K & Joos Krasniqi Sh.P.K”, nuk disponon me të gjitha elementet përmbytësore, me të cilat i përmbyt kriteret në bazë të kontratës që ka me MI dhe këto janë si në vijim:

- *Mungon mbuloja e kripës (hangari) dhe për pasojë kripa është vendosur nën qiellin e hapur.*
- *Zyra për staf.*
- *Streha për makineritë*

Nga renditja tabelore vërehet se operatorit ekonomik ka pasur edhe tre (3) operator tjerë në garë, dhe se

OE fitues sa i përket ofertës financiare është i dyti (2) në renditje, por megjithatë është shpërblyer me kontratë edhe pse ishte me i shtrenjtë në çmim për 8.37 € cent për njësi në krahasim me “Drini Company”. Në procesverbalin për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve të komisionit vlerësues i datës 24.10.2014, theksohet se për llotin Gjakova 2, operatorit ekonomik “Drini Company” është i pa përgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar kushtet në lidhje me udhëheqësin e përcaktuar për këtë projekt, për të cilin nuk ka dhënë referencë/dëshmi mbi përvojën e kaluar. Po ashtu nuk i ka plotësuar kërkesat teknike sa i përket pajisjeve, mjeteve të punës që do të thotë se nuk posedon mjete për realizimin e projektit në këtë llot sipas kërkesave në dosjen e tenderit.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturës rezulton se për vitin 2015 kjo ministri, për katër (4) situacione, deri më datën 13.08.2015, ka paguar vlerën totale prej 480.833.44 €.



REGJIONI: PEJA 1

Në regjionin e Peja 1, Operatori Ekonomik “**Lika TRADE**” Sh.P.K, sipas komisionit vlerësua ky OE ka qenë i përgjegjshëm dhe ka dal me çmimin me të lirë për njësi prej 247.40 €³³. Vlera totale e kontratës është 578,408.62 € për mirëmbajtjen e 112.82 kilometra të

rrugëve. Tabela më poshtë paraqet në detaje ofertat financiare e gjithsej katër (4) ofertuesve për njësi si dhe totalin, dhe dallimin në krahasim me OE fitues.

TAB. 14 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – PEJA 1

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	LIKA TRADE SH.P.K	Performues i Kontrates	€ 74.05	€ 173.35	€ 247.40	€ 0.00
2	GRANIT SH.P.K	OE i papërgjegjshëm	€ 106.37	€ 164.00	€ 270.37	€ 22.97
3	ARFA[1] DECAN	OE i papërgjegjshëm	€ 1,154.65	€ 708.54	€ 1,863.19	€ 1,615.79
4	Ve-Mor & AHN Group	OE i papërgjegjshëm	€ 180.88	€ 48.08	€ 228.96	(€ 18.44)

33 Kontrata ndërmjet MI dhe LIKA TRADE Sh.P.K. - MI/14/051/211, NI I kontratës 064/2014



Nëse e analizojmë dhe krahasojmë OE fitues me ofertuesit tjerë paraqitur si në tabelën më lartë, në kolonën e renditjes mund të vërehet se OE i shpërblyer me kontratë është i dyti në radhë.

Në ofertën financiare të operatorit fitues në këtë region, pozicionit 2.6 (verore) i mungon çmimi. Në raste të tjera të tenderimit dhe sipas dispozitave të LPP-së, në rast se mungon çmimi i pozicionit, i njëjti operator ekonomik diskualifikohet pasi që kjo pikë është aq e shumë e rëndësishme sa që do të mundet të ndryshoj renditja e operatorit fitues meqë diferenca ishte shumë e ngushtë. Ky gabim nuk është gabim aritmetik dhe as gabim i vogël sipas LPP-së, por në praktik është një formë që mundëson keqpërdorim të parasë publike.

Nga Raporti i Inspektoratit, përpiluar nga inspektori i Infrastrukturës Rrugore me datën 12.02.2015 tregon se nga inspektimi i bërë me datën 26.01.2015, inspektorati vjen në përfundim se "kompania në fjalë disponon me te gjitha elementet përmbajtësore, me të cilat i përmbush kriteret në bazë të kontratës që ka me MI". Por shton se "dy nga gjërat që nuk i pati në dispozicion në momentin e inspektimit, (certifika tibi cilësinë e kripës dhe lista e stafit udhëheqës të kompanisë), i solli me datën 29.01.2015 të cilat ju bashkëngjiten dokumentacionit tjetër."

Sipas komisionit vlerësues oferta e Operatorit Ekonomik **Ve-Mor & AHN Group**, i cili ka ofertuar me ofertën më të lirë, ka këto mangësi, të cilat nuk e kualifikojnë si të suksesshëm:

- Nuk ka nënshkruar dhe vëlosur specifikacionet teknike
- Për udhëheqësin e punishtes të paraqitur nuk ka dhënë dëshmi/reference të punës në cilësinë e udhëheqësit të punimeve të lëmisë se kërkuar sipas dosjes së tenderit, minimum dy projekte të realizuara në lëminë e kërkuar.

Në këtë kontekst ankesa e OE "Garaniti" i cili kishte ofertuar më çmim më të lartë për 22.97 €, ishte pranuar si pjesërisht e bazuar nga paneli shqyrtues i OShP-së, megjithatë, nuk kishte ndikuar në vendimin e Autoritetit Kontaktues për dhënie të kontratës.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturës rezultojnë se për vitin 2015 kjo ministri, për shtatë (7) situacione, deri më datën 20.08.2015, ka paguar vlerën totale prej 661.517.90 €, ndërsa nëse këtë punë do të kryente operatori ekonomik i renditur i pari me çmim më të lirë buxheti i Kosovës do paguante 612.211.55 €, respektivisht buxheti i Kosovës për këtë regjion për këtë periudhë kohore të ishte ruajtur për 49.306.35 €.

Në dosjen e tenderit, Regjioni Peja 1 është paraparë rruga R108 në paramasat e tenderit andaj nuk është dhënë arsytim pse është kërkuar për mjete shtese prej shumës **189,961.08 €** për "*Riparimi i Rrugës R108 segmenti Deçan – Manastir; L=2,150.00m, b=6m*". E vetmja arsye që është dhënë, është ajo në kërkesën e menaxherit të kontratës të datës 07.05.2015. Në këtë kërkesë thekson "kërkese kjo nga kryetari i Deçanit z. Rasim Selmani, me vizitën e z. Lutfi Zharku, Ministër i Infrastrukturës, Kuvendit Komunal në Deçan të datës 17.04.2015". Një shpjegim më i mirë duket të jetë në dokumentin e dërguar nga menaxheri i kontratës regjional, të datës 08.01.2015. Përmes kësaj shkrese menaxheri sqaron se rruga regjionale R-108 ka kaluar në regjionin e Pejës edhe pse deri me datën 01.11.2013 kjo rrugë ka qenë me regjion të Gjakovës. Por pse ky fakt nuk është marrë në konsideratë gjatë përgatitje së tenderit kur dihet se procedurat tenderues për këtë tender kishin filluar afërsisht në mes të vitit 2014, kjo nuk është e qartë.



REGJIONI: PEJA 2

Ministria e Infrastrukturës ka hyrë në kontratë me Operatorin Ekonomik “Graniti” Sh.P.K. si i vetmi operator ekonomik i përgjegjshëm për këtë llot. Kjo kontratë është nënshkruar për vlerën 270.37 €³⁴ për njësi, dhe totalin prej 600,209.58 € për mirëmbajtjen gjithsej 155.98 kilometra rrugë. Për këtë regjion kanë aplikuar gjithsej dy (2) operator ekonomik.

● GJETJET:

Nga detajet e raportit të komisionit vlerësues duke se OE “Ve-Mor & AHN Group”, që ishte ofertuesi më i lirë për këtë llot, kishte një mori të dokumenteve të parregullta si kontratë të skaduar me udhëheqësin e

punishtes dhe nuk figuron në listën e ATK-së, kontratat e inxhinierëve për komunikacion dhe gjeodezi të OE fitues janë të pa noterizuara. Dokumentet e tenderit nuk ishin nënshkruar dhe vulosur sipas kërkesës së tenderit.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Infrastrukturës rezulton se për vitin 2015 kjo ministri, për katër (4) situacione ka paguar vlerën totale prej 393,035.62 €, ndërsa nëse këtë punë do të kryente operatori ekonomik i renditur i pari me çmim më të lirë buxheti i Kosovës do paguante 276,827.21 €. Kjo i bje se buxheti i Kosovës për këtë regjion për këtë periudhë kohore të ishte kursyer për 116,208.41 €.

● TAB. 15 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – PEJA 1

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	Graniti sh.p.k	Performues i Kontrates	€ 106.37	€ 164.00	€ 270.37	€ 0.00
2	Ve-Mor & AHN Group	OE i papërgjegjshëm	€ 143.46	€ 46.97	€ 190.43	(€ 79.94)

34 Kontrata ndërmjet MI dhe GRANIT Sh.P.K.. - MI/14/051/211, NI I kontratës 068/2014



REGJIONI: MITROVICA 1

Në Regjioni Mitrovica 1, operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” ka nënshkruar kontratë mirëmbajtjen e 150.12 km të rrugëve nacionale dhe regionale gjatë sezonit veror dhe dimëror. Në këtë lloj kanë aplikuar tetë (8) operator ekonomik. Në vlerë prej 807,027.68 € ose për njësi 299.77 €, për

mirëmbajtjen e 150.12 km të rrugëve nacionale dhe regionale gjatë sezonit veror dhe dimëror. Në këtë lloj kanë aplikuar tetë (8) operator ekonomik.

TAB. 16 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – MITROVICA 1

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	Alko Impex General Construction	Performues i Kontrates	€ 141.44	€ 158.33	€ 299.77	€ 0.00
2	ILEAA-GR	OE i papërgjegjshëm	€ 150.10	€ 180.74	€ 330.84	€ 31.07
3	AGE & Zhubi & Gjoka Construction	OE i papërgjegjshëm	€ 340.81	€ 300.53	€ 641.34	€ 341.57
4	Shkoza F07 & Papenburg & Adriani	OE i papërgjegjshëm	€ 538.76	€ 460.94	€ 999.70	€ 699.93
5	Alb Shpresa & Malësija	OE i papërgjegjshëm	€ 704.18	€ 437.38	€ 1,141.56	€ 841.79
6	Urban & Bislimi	OE i papërgjegjshëm	€ 669.40	€ 471.59	€ 1,140.99	€ 841.22
7	Zahiri & Delta	OE ipapërgjegjshëm	€ 642.18	€ 544.12	€ 1,186.30	€ 886.53
8	R & Rukolli	OE i papërgjegjshëm	€ 1,295.95	€ 839.00	€ 2,134.95	€ 1,835.18



Parregullsia e parë që vërehet në kontratën e nënshkruar është mospërputhja e numrit të prokurimit me sigurimin e ekzekutimit. Numri i prokurimit në kontratë figuron si: MI 14 / 051 / 211, ndërsa në policen e sigurimit të ekzekutimit si dhe në certifikatën e sigurimit për garancinë të kontratës numri i prokurimit figuron të jetë MI 13 / 51 / 211. Për qëllim të realizimit të sigurimit të ekzekutimit numri i identifikimit të kontratës nuk është aspak relevant dhe në rast se paraqit nevoja për realizimin e sigurimit, një gjë e tillë është e mundur në bazë të numrit të prokurimit.

Për dallim nga regjionet tjera, në këtë rast OE fitues është renditur i pari për çmimin më të lirë. Megjithatë, disa parregullsi janë vërejtur gjatë inspektimit në lokacionin e OE "Alko-Impex General Construction", e bërë me datën 19.01.2015, me numër të procesverbalit 007866, 007867, 007868. Inspektor i Infrastrukturrës Rrugore me datën 29.01.2015, me qëllim të eliminimit të pa rregullsive ka nxjerr Aktvendim që brenda 30 ditëve të evitohen pa rregulluesit të gjetura gjatë inspektimit si në vijim:

- Nuk posedon kushtet të nevojshme për punë në zyre në bazën lokale për mirëmbajtjen dimërore dhe verore ku janë të vendosur personeli dhe logjistika, si: kompjuter, internet, etj bazuar në kontratë;
- Nuk posedon urdhëresat e rrugës – ditore për automjetet dhe shoferët,
- Nuk posedon certifikatën e tahografit për automjete (kamion);
- Nuk posedon kushtet teknike adekuate sipas kontratës për mbulojën e kripës;
- Nuk posedon kushte teknike adekuate sipas kontratës për mbulojën si dhe mirëmbajtjen e automjeteve;

- Nuk posedon shenja sinjalizues ndriçues elektrik për punime në rrugë, si dhe
- Nuk posedon drita rotative të portokalltë mbi automjetin përcjellës.

Të gjithë operator tjerë ekonomik kishin ofruar çmim më të shtrenjtë se operatori ekonomik fitues. Megjithatë, ky fakt nuk e minimizon faktin se parregullsitë e gjetura duhet tejkaluar si kompromise për çmimin më të lirë. Në rast të tilla po ti ishte bërë inspektimi i operatorit fitues në terren para dhënies së kontratës, gjasat reale janë se AK është dashur të diskualifikoj edhe këtë OE si të papërgjegjshëm. Si rrjedhojë hap i duhur në këto rrethana për AK do të ishte të rishpallet tenderi përsëri. Asnjëri nga operatorët ekonomik nuk ka ushtruar të drejtën e ankesës për këtë regjion.

Në këtë regjion OE fitues është i renditur i pari më çmimin më të lirë dhe për vitin 2015 buxheti i Kosovës për mirëmbajtjen e këtij regjioni për dhjetë (10) situacione ka paguar 822,938.06 €.



REGJIONI: MITROVICA 2

Operatori ekonomik i shpërblyer më kontratë për regjionin Mitrovica 2 është **“P.P. JASEN”** me vlerë të kontratës: 462,782.11 € ose për njësi 1,313.97 €³⁵, për mirëmbajtjen e 116.52 km të rrugëve nacionale dhe regjionale gjatë sezonin verorë dhe dimërorë. Në këtë llot operatori ekonomik fitues ka pasur vetëm një konkurrent.

●● GJETJET:

Operatori i dytë në renditje ishte me çmim me të lartë për 285.49 € cent për njësi. Duke ju referuar raportit të komisionit vlerësues vërehet se operatorit të dytë në renditje i mungojnë një morie dokumentesh, po thuajse në të gjitha grupet e kriteve, qofshin ato

teknike, financiare apo profesionale. Në realitet, duket se rëndësia e aplikimit të OE **“Road Trade”** duket të jetë vetëm sa për plotësimin e kushtit ligjor prej dy operatorëve ekonomik.

Sikurse në regjionin Mitrovica 1, edhe në regjionin Mitrovica 2, vërehet një konfuzion në emërtim. Në dosjen e tenderit i referohet si Mitrovica 2, ndërsa në kontratën e nënshkruar është përdorur Mitrovica B.

Siç është theksuar edhe në raportin e KDI, në vitin 2014,³⁶ kontrata e këtij operatori edhe kësaj radhe shqërohet me parregullsi për shkak se i mungojnë çmimet e pozicionit 4.3.7 (dimëror). Kësaj radhe po ashtu duket se nuk ka pasur gjasa të fitoj tenderin tjetër operator ekonomik, përveç kësaj kompanie, sepse nuk ka

●● TAB. 17 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – MITROVICA 2

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	P.P. JASEN	Performues i Kontrates	€ 714.73	€ 599.24	€ 1,313.97	€ 0.00
2	Road Trade	OE i papërgjegjshëm	€ 1,071.92	€ 454.78	€ 1,599.46	€ 285.49

35 Kontrata ndërmjet MI dhe P.P.JASEN.-MI/14/051/211, NI I kontratës 060/2014

36 KDI (Mars, 2014), Prokurimi Publik në Ministrin e Infrastrukturrës, faqe 20.

pasur një konkurrent aspak serioz. Mandej, mos marrja e asnjë ofertë nga kompanitë me pronar shqiptarë, për shkak të problemeve që mund të ketë në zbatimin e kontratës në këtë pjesë të Kosovës (pjesa veriore), dhe problemet serioze me sundimin e ligjit janë po ashtu indikator shtesë se kontrata është destinuar të shkoj për OE fitues. Në këto rrethanë të krijohet bindja se edhe raporti i datës 10.02.2015, i inspektorit të Ministrisë së Infrastrukturës se “kompania në fjalë nuk kishte asnjë vërejtje sa i përket kushteve administrative dhe teknike bazuar në kontratë”, duket të jetë produkt i solidarizimit me rrethanat faktike të cekura me lartë, por assesi inspektim real. Ngjashëm, më regjionin e Mitrovica 1, edhe për këtë regjion nuk ka pasur ndonjë ankesë kudër vendimit të AK për dhënie të kontratës.

Po ashtu, në këtë regjion OE fitues është i renditur i pari më çmimin me të lirë dhe për vitin 2014 dhe vitin 2015 buxheti i Kosovës për mirëmbajtjen e rrugëve në këtë regjionin për gjashtë (6) situacione ka paguar 485,775.27 € cent.



REGJIONI: GJILANI 1

Ofertuesi i vetëm me të cilin Autoriteti Kontraktues ka nënshkruar kontratë është operatori ekonomik **“TALI”** sh.p.k. për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës për 123.58 kilometrash. Kontrata e nënshkruar ka koston prej 653,522.45 EURO, ndërsa kostoja për njësi e kësaj kontratë është 461.05 EURO³⁷. OE fitues nuk kishte asnjë konkurrent për këtë regjon.

●● GJETJET:

Sipas një raporti të Ministrisë së Infrastrukturës, që mban datën 12.02.2015, përpiluar nga Inspektori i Infrastrukturës Rrugore ndër të tjera thekson së me datën 06.02.2015 kemi inspektuar kompania “Tali” me seli në Gjiłan paraparë sipas kontratës dhe “pas konstatimit dhe verifikimit të së njëjtës në procesver-

bal ku në përfundim kam konstatuar që për një afat kohor të shkurtër të bëj përmirësimin mbi elementet e të metave”. Por ky raport nuk thekson së për cilat të meta behët fjalë, dhe po ashtu nuk tregon numrin referent të procesverbalit.

Vlen të ceket së në të njëjtin raport theksohen gjetjet e inspektimit edhe për tri (3) regjione tjera dhe për dallim nga raportimi për regjon e Gjiłanit 1, për tri regjionet tjera të inspektuar dhe përpiluar nga i njëjti inspektor, parregullsitë janë të shënuara në mënyrë të qartë. Pse nuk janë dhënë në mënyrë të qartë parregullsitë për regjionin Gjiłani 1, nuk ka ndonjë shpjegim veç se lë dyshim për manipulime të ndryshme. Shtuar kësaj edhe faktin se është i vetmi regjon ku ka pasur vetëm një ofertë, respektivisht oferta e operatorit fitues, i bën edhe me të fuqishme dyshimet për parregullsitë dhe mundësitë e prezencës së korrupsionit.

●● TAB. 18 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – GJILANI 1

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total
1	“TALI” sh.p.k.	Performues i Kontratës	€ 191.28	€ 269.77	€ 461.05

37 Kontrata ndërmjet MI dhe TALI Sh.P.K. - MI/14/051/211, NI I kontratës 054/2014

Është vështirë që të jetë rastësi që për regjionin Gjilani 2 të ofertojnë gjithsej pesë (5) operatorë ekonomik por në Gjilani 1 të mos ketë as një operator të interesuar kur dihet se nga konkurrentet kryesor në rajonin e Gjilanit janë OE “Tali” dhe “Magjistranja”. Madje në vitin 2014, lënda nga çështja administrative, kishte kaluar në penale, pasi palët kanë paraqitur lëndët në njësinë e krimeve ekonomike të Policisë së Kosovës dhe në Policinë e Eulex-it.³⁸

Pra në tenderin paraprak, problemet më të mëdha ishin në këtë regjion, me gjithsej 4 ankesa në të gjitha fazat e tenderimit, dy herë ishte shpallur tenderi për shërbimet e kontratës së njëjtë, ndërsa, në tenderin aktual nuk kishte pasur asnjë ankesë dhe i gjithë ky rivalitet aq i madh përfundoj madje edhe pa as një konkurrent të vetëm.

Në lidhje më këtë operatorët ekonomik “Magjistranja” gjatë grupit të punues organizuar nga KDI me datën 29 Janar 2016 ndër arsyet e mos aplikimit për këtë regjion thekson “tenderët janë të kurdisur meqë në Gjilan dhe Mitrovicë të njëjtit OE po i marrin tenderët qysh 15 vite tash, dhe OE të tjerët nuk kanë asnjë shancë. Eliminimi i OE bëhet në mënyrë favorizuese, disa kompani diskualifikohen pse nuk i kanë pajisjet për të gjitha llotet, përdërisa jepen kontrata OE-ve që nuk i kanë të gjitha pajisjet as për llotin e fituar, ose me pajisjet e prezantuara i jepet puna për një llot.”³⁹

Shtuar këtyre rrethanave edhe faktin se ishte vetëm një ofertues, lindin dyshimet e arsyeshme se mos kjo kontratë ishte e kurdisur. Si ishte e mundur që në të gjitha regjionet tjera kishte mesatarisht 3 apo 4 ofertues, ndërsa në regjionin Gjilani 1, vetëm një ofertues? Një dyshim i tillë, ishte në fakt pretendimi i operatorit ekonomik “Magjistranja” e cila në vitin 2014 i kishte hedhur akuza se dy kompanitë tjera në atë tender “Tali” dhe “Integral” kanë bërë kurdisje të tenderit, vetëm për të plotësuar kushtin e dy (2) ofertave të përgjegjshme.⁴⁰

38 KDI (Mars, 2014), Prokurimi Publik në Ministrin e Infrastrukturrës, faqe 22.

39 KDI, Grupi Punues i mbajtur me datën 29.01.2016.

40 KDI (Mars, 2014), Prokurimi Publik në Ministrin e Infrastrukturrës, faqe 23.

Për këtë procedurë tenderuese nuk kishte asnjë ankesë të deponuar në OShP, edhe pse në procedurën tenderuese paraprake për të njëjtën natyrë të shërbimeve nga gjithsej tetë (8) ankesa, katër (4) prej tyre ishin vetëm për këtë regjion.⁴¹

Procedurat e tenderimit për regjionin Gjilani 1 janë në kundërshtim me nenin 32.4⁴² dhe 32.5⁴³ të LPP-së si dhe më Udhëtuesin Operativ pasi që nuk ka bazë të pretendohet se është e arsyeshme të vazhdohet me një ofertë si përjashtim në përputhje me nenin 32.5 të LPP-së. Derisa në regjionin Gjilani 2 kanë ofertuar gjashtë (6) operator ekonomik dhe se tradicionalisht në këtë regjion ka pas konkurrent të përjetuar, nuk rezultojn se ky përjashtim është përmbushur. Autoriteti Kontraktues është dashur që për këtë regjion ta anulojë procedurën në përputhje me nenin 32.4 të LPP-së dhe t’i kthejë aplikacionet e pranuar me shpjegime se janë pranuar më pak se 2 kërkesa për pjesëmarrje.

Në këtë regjion ishte vetëm një ofertues dhe për vitin 2015 buxheti i Kosovës për mirëmbajtjen e rrugëve të këtij regjioni, për shtatë (7) situacione, deri me datën 20.10.2015, ka paguar 1,123,846.06 e€. Vlera totale e kësaj kontrate është 653,522.45 e€, që do të thotë se deri me datën e paracekur, MI ka paguar 470,323.61e€ (72% të vlerës totale së kontratës), më shumë.

41 Po aty.

42 Nenin 32 (4) Nëse, gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit.

43 Nenin 32 (5) Pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni kur më pak se dy tender të përgjegjshëm apo kërkesa për pjesëmarrje janë dorëzuar në përgjigje të një procedure të hapur, procedure të kufizuar apo procedure të negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë, me kusht që a) specifikimet e para të kontratës nuk ndryshohen b) që autoriteti kontraktues ka demonstruar që për arsye të konkurrencës shumë të kufizuar në treg për kontratën në fjalë, një procedure e re e hapur, e kufizuar ose e negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë nuk do të rezultoi në ngritje të numrit të tenderëve përgjegjës, kur është e aplikueshme, kërkesat për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues mund të anuloi këtë kërkesë. Megjithatë KRPP duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues përkatës brenda dy ditëve nga dita e vendimit për anulimin e kërkesës.



REGJIONI: GJILANI 2

Ofertuesi me çmimin më të lirë dhe më të cilin Autoriteti Kontraktues ka nënshkruar kontratë është operatori ekonomik “Jaha Company & Toifor” Sh.P.K. Për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe rajonale të

Kosovës prej 111.58 kilometrash. Kontrata e nënshkruar ka koston prej 600,341.01 €, ndërsa kostoja për njësi e kësaj kontratë është 203.59 €⁴⁴.

●● TAB. 19 KRAHASIMI I OFERTAVE FINANCIARE NË REGJIONIN – GJILANI 2

Totali i Ofertës për pesë (5) pozicione (Njësi)

#	Operatori Ekonomik	Statuti	Mirëmbajtja Verore	Mirëmbajtja Dimërore	Total	Dallimi me OE performuese
1	“Jaha Company & Toifor” sh.p.k.	Performues i Kontrates	€ 116.43	€ 87.16	€ 203.59	€ 0.00
2	Zuka Commerc	OE i papërgjegjshëm	€ 244.88	€ 410.95	€ 655.83	€ 452.24
3	Magjistralja Bageri	OE i papërgjegjshëm	€ 415.13	€ 530.06	€ 945.19	€ 741.60
4	Bejta Commerc & Bas Com	OE i papërgjegjshëm	€ 892.54	€ 556.59	€ 1,449.13	€ 1,245.54
5	Tali	OE i papërgjegjshëm	€ 211.99	€ 359.11	€ 571.10	€ 367.51
6	Shkoza F07 & Papenburg + Adriani	OE i papërgjegjshëm	€ 398.63	€ 568.95	€ 967.58	€ 763.99

44 Kontrata ndërmjet MI dhe JAHA Company SH.P.K. & TOIFOR Sh.p.k. Sh.P.K.-MI/14/051/211, NI I kontratës 065/2014

GJETJET:

Për dallim nga regjioni Gjilani 1, në këtë regjion i kemi gjithsej gjashtë (6) ofertues ku edhe rezultati ishte shumë më i mirë për të ruajtur paranë publike. Nga ofertat e pranuar për këtë regjion dallimi më i ulët me çmimin më të lirë për njësi është 367.51 €, renditur si i dyti në tabelë. Ndërsa çmimi më i lartë në krahasim më çmimin më të ulët të ofruar nga kompania fituese është 1,245.54 €.

Në raportin e inspektimit nga inspektorët e Ministrisë së Infrastrukturës të datës 12.02.2015, dhe inspektimi i bërë me datën 06.02.2015, si të meta apo parregullsi ishin gjetur të jenë:

- Mos posedimi i hangarit për mbulojën e kripës dhe
- Gjendja teknike e automjeteve nuk ishte vlerësuar mirë.

Edhe me parregullsitë që janë evidentuar, dhe krahasuar me çmimet e larta të ofruara nga operatorët tjerë ekonomik, dhe nëse inspektimi do të ishte bërë para dhënies së kontratës, del se konkludimet e komisionit vlerësues për këtë regjion të jenë më të mirat të mundshme për këtë regjion. Si do që të jetë, mbet për tu parë si do të shkojë procesi i realizimit të kësaj kontrate, marrë parasysh faktin se çmimi i ofruar është tejte i ulët në krahasim me pesë (5) ofertuesit tjerë.

Në këtë regjion OE fitues është i renditur i pari më çmimin më të lirë dhe për vitin 2015 buxheti i Kosovës për mirëmbajtjen e rrugëve në këtë regjion për shtatë (7) situacione, deri më datën 16.10.2015 ka paguar 598,408.68 €.

ANKESAT E OPERATORËVE EKONOMIKË DHE EFIKASITETI I TRAJTIMIT TË TYRE

Në lidhje me këtë procedure të tenderimit, janë deponuar disa ankesa nga palët e interesit, respektivisht operatorët ekonomik. Pas kërkesës për qasje në dokumente publike, OShP konfirmoi se gjithsej janë deponuar tetë (8) ankesa, nga operatorët ekonomikë. Një (1) ankesë është deponuar para mbylljes së afatit për dorëzim të ofertës dhe shatë (7) ankesa janë deponuar pas dhënies së kontratave.

Operatori ekonomik “Victoria Invest International”⁴⁵ Sh.P.K me numër të protokollit 214/14, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale për vitin 2014”, me numër prokurimi MI/14/051/211, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) Ministria e Infrastrukturs. Pretendimet ankimore të OE kishin të bëjnë se gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar nenin 7, 56, 65, 68, dhe 69 të LPP-së. Nga këndvështrimi i OShP-së, vetëm pretendimi ankimor për shkelje të nenit 69 të LPP-së, në lidhje me paragrafin 9.1 dhe paragrafin 9.2 të FDT është i bazuar sepse sa i përket mundësive teknike dhe profesionale, janë kriteret të sakta se a kalon apo nuk kalon. Sipas vendimit të OShP-së, në bazë të cilit AK e ka shtyrë

afatin e dorëzimit të ofertave, kjo “nënkupton se nëse kërkesat janë përmbushur tenderët nga tenderues të tillë janë ende në konsideratë, e nëse nuk janë përmbushur këto kërkesa atëherë tenderët e dorëzuar nga tenderuesit e tillë do të refuzohen menjëherë”.⁴⁶

Shtatë ankesa tjera janë deponuara në OShP. Të gjitha këto ankesa janë trajtuar bashkërisht dhe për të gjitha këto ankesa është dhënë vendim i përbashkët.⁴⁷ Pretendimet ankimore ishin nga më të ndryshmet. Sipas Operatorit Ekonomik “Graniti” Sh.P.K ky operator pretendon se për regjionin Peja 1, qysh në fillim ishte ndier i diskriminuar sepse edhe pas tri kërkesave të dërguara Autoritetit Kontraktues nuk ju ishte lejuar qasje ne dokumente zyrtare, pretendim ky i vlerësuar në vendimin e OShP-së si devijim i vogël. Paneli shqyrtues po ashtu vërtetoi në raportin e komisionit vlerësues se ky operator ka dorëzuar një diplomë të pa vulosur dhe të panëshkruar nga universiteti që e ka lëshuar, prandaj është konstatuar se ky operator nuk e ka plotësuar piken 9.1.3 të FDT-së, dhe si i tillë është i papërgjegjshëm. Ndërsa sa i përket vlerësimit të Komisionit vlerësues se OE Graniti posedon shofer

⁴⁶ Po aty, faqe 4.

⁴⁵ <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2014/rrug-verore-dimer-nacion-regjion.pdf>

⁴⁷ Vendimi i OShP-së i datës 17.12.2014, https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2014/mirimb_ver-dim_rrug-nacion-ks.pdf.

vetëm për një llot, nuk qëndron dhe vendimi i OShP-se i jep të drejt operatorit ekonomik në fjalë.

Ankesa e operatorit ekonomik “RSM & JOOS KRAS-NIQL BAZE”, për regjionet Gjakova 1, Ferizaj 1 dhe Ferizaj 2 sipas vendimit të OShP-së ishte po ashtu pjesërisht e bazuar. Vendimi i OShP-së, i validon vlerësimet e Komisionit vlerësues në lidhje me mungesën e udhëheqësisë së stafit menaxherial në listën e ATK-së, dhe se menaxheri i projektit nuk kishte referenca adekuate. Sa i përket vlerësimeve të komisionit vlerësues se OE në fjalë nuk disponon mjete të mjaftueshme të punës nuk qëndron.

Në lidhje me eliminimin e OE ankues “Conex Group & ITK” në regjionin Prishtina 2, vendimi i OShP-se thekson së operatori nuk e ka ofruar listën e pajisjeve në përputhje me dosjen e tenderit, sepse kjo listë ishte ofruar për regjionin e Ferizajt, ndërsa ky operator ekonomik ka ofertuar për regjionin Prishtina 2. “Gjithashtu paneli shqyrtues konstatoi se lista e dorëzuar, është në shpërputhje me titullin, që nuk përmban emërimin e saktë të pjesës ku duhet kryer shërbimet, pra për cilin llot ka konkurruar”.⁴⁸ Megjithëse, ky gabim i natyrës teknike mund të konsiderohet si devijim i vogël, prapë së prapë operatori ekonomik ka ofertuar me dy kamion më pak se që është kërkuar në dosjen e tenderit. Por siç mund të vërehet në raportin e inspektorëve në terren, edhe operatori ekonomik fitues kishte dy kamion me pak.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Vemore & AHN Group” se i është bërë e pa drejtë në regjionet Peja 1 dhe Peja 2, janë hedhur poshtë sa i përket ofertimit me specifikimeve teknike të pa nënshkruara dhe të pa vulosura sepse nuk janë në përputhje më piken 3.1 të FDT. Po ashtu, ofertimi me kontratë të skaduar për udhëheqësin e punishtes si dhe mungesa e të qenurit në listën e ATK-së janë dy kërkesa në shpërputhje me dosjen e tenderit. Përkitazi më pretendimet tjera që komisioni vlerësues ka vlerësuar se nuk i ka përmbushur, vendimi i OShP-së i konsideron si të bazuara.

⁴⁸ Vendimi i OShP-së i datës 17.12.2014, faqe 11.

Më tej, vendimi i OShP-së, për regjionin Gjilani 2, vërteton gjetjet e komisionit vlerësues përkitazi më eliminimin e operatorit ekonomik “Magjistranja” se e njëjta nuk i ka prezantuar raportin e auditorit për tri vitet e fundit. Por gjatë seancës dëgjimore u prezantuan një aktvendim dhe një aktgjykim lëshuar nga Gjykata Themelore Prishtinë, vendime këto që e kanë dënuar operatorin në fjalë. Në këtë kuptim, ky operator ekonomik nuk mund të ofertoj sepse është në kundërshtim më nenin 65.4.7 të LPP-së.

Ngjashëm me operatorët tjerë ankues, pretendimet ankimore në regjionin Gjakova 1, të OE “Malsija” vërtetohen si pjesërisht të bazuara përveç pretendimeve ankimore që kanë të bëjnë me dorëzimin e licencës së asfaltit të skaduar, si dhe mungesa e licencës për gurthytes. Pra, në lidhje më kërkesën e kapitalin të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, dhe kinse nuk e ka noterizuar kontratën e punës për këtë projekt për inxhinierin e gjeodezisë, nuk qëndrojnë sipas vendimit të OShP-së.

OE i fundit ankues për regjionin Gjakova 2 është “Victoria Invest International”, për të cilën, vendimi i OShP-së vendosi ngjashëm duke i aprovuar pjesërisht të bazuar pretendimet ankimore të sajë. Operatori Ekonomik kishte ofertuar me të njëjtat pajisje për dy lloje, gjë që ishte në kundërshtim më kërkesat e dosjes së tenderit, i cili ka kërkuar pajisje të ndryshme për secilën ofertë. As në raportin e komisionit të vlerësimit dhe as në vendimin e OShP-së nuk cekën së cilat janë pretendimet ankimore pjesërisht të bazuar.

Me datën 23 qershor 2014 OE Tali Sh.P.K ka kërkuar nga AK vazhdimin e afatit se paku edhe për 10 ditë me arsyetimin se deri në momentin e kërkesës OE nuk i ishte dërguar dosja e tenderit.

REKOMANDIME

Duke u bazuar në të gjeturat e këtij raporti, KDI ofron rekomandimet e më poshtme për Ministrinë e Infrastrukturrës:


- Inspektimi i Operatorëve Ekonomik si pjesë e procesit të vlerësimit të ofertave të bëhet pjesë e obligueshme, me ç ‘rast vlerësimi nuk do të varej në mirëbesim, por në fakte, dhe do të kishim një vlerësim më të drejtë të kapaciteteve teknike dhe profesionale, që do të mundësonin kursimin dhe menaxhimin e mirë të parasë publike;
- Për të evituar situatat e këtilla, kur për shkak të modifikimeve, ankesave dhe parregullsive në dosjet tenderuese vie deri tek revokimi i neneve apo pranimi i kushteve jo në favor të publikut, për shërbimet e vazhdueshme procesi i prokurimit të filloj menjëherë me aprovimin e buxhetit dhe planifikimit të prokurimit, në mënyrë që të ketë kohë të mjaftueshme për anulimin dhe ritenderimin e shërbimeve;
- Të monitorohen shërbimet e përfunduara në përputhje me kushtet e kontratës, dhe të mos lejohen shërbime shtesë, të cilat kalojnë vlerat e kontraktuara;
- Të rritet efikasiteti i transparencës së Ministrisë së Infrastrukturrës, respektimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit të Prokurimit Publik;
- KRPP të shtoj monitorimin veçmas në kontratat e ndara në shumë llote dhe me vlera të mëdha si gjatë procesit të tenderimit, po ashtu edhe gjatë performances së kontratës;
- Të mbikëqyret dhënia e kontratave me çmime jo normalisht të ulëta dhe kontratat ku çmimet janë shumë të larta në raport me çmimet e tregut, dhe vet çmimet e ofertuesve;
- T’i kushtohet vëmendje paraqitjeve me oferta fiktive, vetëm sa për të plotësuar kushtin ligjor për dy oferta të përgjegjshme, apo kur ka dyshime për kurdisje të tenderëve;
- Ministria e Infrastrukturrës të shtoj monitorimin e zbatimit të kontratave dhe në rastet e vonesave apo kualitetit të dobët të aplikoj gjoba për operatorët ekonomik;

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.71/.72(496.51)

Rruga tek paratë : monitorimi i prokurimit publik në
ministrinë e infrastrukturës : mars 2016 / Instituti
Demokratik i Kosovës. – Prishtinë : Instituti Demokratik i
Kosovës, 2016. –
52 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

ISBN 978-9951-8927-4-2



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy
Pristina

